

UNIVERSITETI I EVROPËS JUGLINDORE
SOUTH EAST EUROPEAN UNIVERSITY
УНИВЕРЗИТЕТ НА ЈУГОИСТОЧНА ЕВРОПА



FAKULTETI IDREJTËSISË
FACULTY OF LAW
ПРАВЕН ФАКУЛТЕТ

STUDIME TË CIKLIT TË DYTË

DREJTIMI PENAL

TEZA:

**“Aspekte juridiko-penale dhe krahasimore të veprës
penale "Trafikim me fëmijë””**

Kandidate:

Esra Axhami

Mentore:

Doc. Dr. Vedije Ratkoceri

Tetovë, 2022

DEKLARATA E AUTORËSISË

Nën përgjegjësinë time personale, deklaroj se përmbajtja e temës së magistraturës së paraqitur është punë origjinale e shkruar prej meje, e cila nuk është prezantuar asnjëherë para ndonjë institucioni tjetër për vlerësim dhe nuk është botuar i tëri ose pjesë të veçanta të tij. Të gjitha referencat dhe citimet në tekst janë bërë në bazë të burimeve të paraqitura në fusnota.

Me respekt

()

PËRMBAJTA

Abstrakt	5
Abstract.....	6
Hyrje.....	6
Kapitulli I – Njohuri të përgjithshme mbi trafikimin e qenieve njerëzore	8
1. Nocioni i trafikimit të qenieve njerëzore.....	8
2. Shkaqet e paraqitjes së trafikimit me qenie njerëzore.....	10
3. Viktimat e trafikimit me qenie njerëzore.....	10
4. Format kryesore të trafikimit.....	11
4.1 Punë e detyruar.....	12
4.2 Trafikimi seksual.....	13
4.3 Ushtraë fëmijë.....	13
4.4 Trafikimi seksual i fëmijëve	14
5. Pasojat e trafikimit të qenieve njerëzore.....	15
Kapitulli II – Trafikimi me fëmijë	18
1. Llojet e trafikimit të fëmijëve.....	18
2. Faktorët që ndikojnë në trafikimin e fëmijëve.....	20
3. Luftimi, parandalimi dhe mbrojtja nga trafikimi i fëmijëve.....	21
4. Interneti dhe teknologjia.....	24
5. Faktorët socio-ekonomik dhe covid-19 në trafikimin e fëmijëve.....	26
Kapitulli III – Instrumentet ndërkombëtare për mbrojtjen e fëmijëve nga trafikimi.....	28

1. Konventa e të drejtave të fëmijëve (1989).....	28
2. Karta e OKB-së dhe të drejtat e njeriut	30
3. Konventa Evropiane e të drejtave të njeriut-për mbrojtjen e fëmijëve.....	32
4. Protokolli opsional i Konventës për të drejtat e fëmijëve mbi shitjen e fëmijëve, prostitucion me fëmijë.....	33
5. Protokolli i Palermos -mbi parandalimin, shtypjen dhe ndëshkimin e trafikimit me fëmijë.....	34
6. Deklarata e Brukselit për pengimin e trafikimit.....	36
7. Konventa kundër Krimit të Organizuar - Prokollit shtesë për ndalimin e trafikimit me fëmijë.....	37

Kapitulli IV – Vështrim krahasues i disa legjislacioneve bashkëkohore lidhur me trafikimin e fëmijëve.....40

1. Trafikimi me fëmijë në Afrikë.....	40
2. Trafikimi me fëmijë në Gjermani.....	43
3. Trafikimi me fëmijë në SHBA.....	45
4. Trafikimi me fëmijë në Kosovë.....	46
5. Trafikimi me fëmijë në Shqipëri.....	49
6. Trafikimi me fëmijë në RMV.....	54

Përfundime dhe rekomandime.....59

Literatura e shfrytëzuar.....61

ABSTRAKT

Një ndër problematikat kryesore të botës bashkëkohore për sa i përket mirëqenies së fëmijëve është edhe viktimizimi i tyre në forma të ndryshme. Si një ndër format më të rrezikshme të dëmtimit të mirëqenies së fëmijëve pa dyshim është edhe shfrytëzimi i tyre për qëllime dashakeqe. Problematikë e tillë është pikërisht vepra penale e trafikimit me fëmijë.

Trafikimi me qenie njerëzore e veçanërisht trafikimi me fëmijë sot ka marr një hov të madh në botën bashkëkohore. Është kështu për shumë arsye ku mund të përmendim zhvillimin e teknologjisë, paraqitjen e formave të reja të kriminalitetit, mobilitetin gjithnjë e më të madh të njerëzve, krizat e ndryshme ekonomike, luftërat etj.

Në këtë punim të magjistraturës është trajtuar pikërisht kjo formë e kriminalitetit, pra trafikimi me qenie njerëzore me theks të veçantë trafikimi me fëmijë. Kjo temë kryesisht ka trajtuar aspektin juridiko-penal të kësaj vepre penale duke u ndalur në inkriminimet juridike të kësaj vepre si në legjislacionet nacionale ashtu edhe në të gjitha dokumentet e rëndësishme ndërkombëtare të cilat janë trajtuar veç e veç.

Në pjesën e fundit të kësaj teme është trajtuar aspekti krahasimor i trajtimit juridiko-penal ku në mënyrë gjithpërfshirëse kemi trajtuar disa legjislacione dhe rregullimin juridik të kësaj vepre penale në Afrikë, SHBA, Gjermani e pastaj në vendet e rajonit si në Kosovë, Shqipëri, për tu ndalur në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

Duke analizuar aspektin juridiko-penal dhe krahasimor të kësaj vepre penale në fund kemi rezultuar me përfundime dhe rekomandime të rëndësishme në inkriminimin e kësaj vepre penale, e gjithë kjo me qëllim të luftimit dhe parandalimit më efikas të kësaj forme të kriminalitetit.

Fjalët kyçe : trafikimi i fëmijëve, rrezikshmëria , fëmija viktimë, shfrytëzimi, legjislacion, mbrojtja e fëmijëve

ABSTRACT

One of the main problems of the contemporary world in terms of the well-being of children is their victimization in various forms. As one of the most dangerous forms of harm to the well-being of children is undoubtedly their exploitation for malicious purposes. Such a problem is precisely the criminal offense of child trafficking.

Trafficking in human beings, and in particular child trafficking, has taken off in the modern world today. This is so for many reasons where we can mention the development of technology, the introduction of new forms of crime, the increasing mobility of people, various economic crises, wars, etc.

In this master thesis is addressed exactly this form of crime, ie trafficking in human beings with special emphasis on trafficking in children. This topic has mainly addressed the legal-criminal aspect of this criminal offense, focusing on the legal incriminations of this offense both in national legislation and in all important international documents which have been addressed separately.

In the last part of this topic is treated the comparative aspect of legal-criminal treatment where we have comprehensively addressed some legislation and legal regulation of this criminal offense in Africa, USA, Germany and then in the countries of the region such as Kosovo, Albania, for to stop in the Republic of Northern Macedonia.

Analyzing the legal-criminal and comparative aspect of this criminal offense, we have finally resulted in important conclusions and recommendations in the incrimination of this criminal offense, all with the aim of combating and preventing this form of crime more effectively.

Keywords: child trafficking, , victims, legislation, child protection.

HYRJE

Bota sot po përballet me një vështirësi të madhe dhe të rëndë për ta kontrolluar, trafikimi i qenieve njerëzore në veçanti të fëmijëve, e njohur si temë globale në gjithë botën, në aspekte negative e shfaqur në gjithë rrethin shoqëror, dhe me këtë neve vetëm se po përballemi me një problem mjaft të përhapur dhe pjesë të pandashme të jetesës tonë, ku kjo formë e trafikimit vetëm se po zhvillohet në forma të ndryshme të shkeljes, ndëshkimit , pushtimit së të drejtave thelbësore të njeriut apo të fëmijut. Duke u bazuar në të gjithë këtë kaos, trafikimi me fëmijë është shëndruar në një biznes mjaft të gjërë fitimruesës, i karakterizuar nga dhuna, skllavëria, keqtrajtimit nga aktivitete të ndryshme të organizatave kriminale.

Në këtë punim, kemi trajtuar trafikimin e fëmijëve si një formë e manifestimit të krimit të organizuar, duke pasur parasysh rrezikun dhe kërcënimet që shpalosen, por me pak gjasa që një fëmijë të kupton situatën se është viktimë e një trafikimi. ketu do të trajtojmë dhe hulumtojmë format e trafikimit me fëmijë, shkaqet se pse vjen deri tek trafikimi i fëmijëve, viktimat e trafikimit të fëmijëve, duke u cenuar dhe shkelur të drejtat e fëmijës, pasojat që shkaktohen në mënyrë të dhunshme, masat për mbrojtjen dhe parandalimin e trafikimit të fëmijës, dhe ne fund analizë ne kontekst më të thellë, krahasime te legjislacioneve bashkëkohore. Duke pasur parasysh gjithë këtë hulumtim ndaj një krimi shumë te rrezikshëm, rëndësi të posacme duhet të theksojmë edhe ndaj instrumenteve ndërkombëtare për mbrojtjen e fëmijëve, kontributit të tyre për të arritur nivelin e duhur të sigurisë shoqërore.

Në këtë temë, qëllim kryesor është të shohim sa është kontributi i institucioneve në mbrojtjen e fëmijës, pse vjen në përfundim që fëmija të jetë viktimë e një krimi, sa është e lehtë zbulimi i rasteve në mbrojtje të fëmijëve, dhe jo cdo vuajtje e fëmijëve sa është e mbrojtur në gjitha legjislacionet e botës, konkretisht sa është i rëndësishëm dënimi dhe sanksioni i këtij krimi në cdo ligj dhe kod penal të cdo shteti.

Vlen edhe të potencohet se rëndësia e këtij punimi qëndron në kontributin për të fituar material të mjaftueshëm për mbrojtjen dhe parandalimin e kësaj lufte të trafikimit të fëmijëve. Trafikimi me fëmijë si fenomen i përhapur dhe egzitues në mbarë botën, rrezikshmëria e saj

vetëm se shkon drejt një rritje më të madhe, duke ndikuar në masë të madhe në jetën dhe ardhmërinë e fëmijëve. Trafikmi me fëmijë është një shkak i cili po sundon botën me një efekt negativ, ku fëmijët cdo ditë po pengohen që të marrin hapat e sukseseve të tyre.

Kohët e fundit neve vetëm se shofim për tragjeditë që ndodhin rreth fëmijëve si në Maqedoni ashtu edhe në botën ndërkombëtare, që është një temë mjaft e përfolur, dhe asgjë nuk dihet se deri ku është ky destinacion i ardhshëm i fëmijëve. Rreziku i këtij organizimi kriminal ka marrë zhvillim të madh edhe nga teknologjitë, dhe interneti ku sot është varësi e gjithë botes. Me gjithë këtë kuptohet që në shumë legjislacione të botës janë ndërmarë masa për kontrollin e këtij krimi, dhe mbrojtje të fëmijëve të pafajshëm.

Dhe me këtë studim duke hulumtuar gjitha instrumentet ndërkombëtare vetëm se do të kemi lehtësim dhe mënyre më efikase për ta mbrojtur dhe për ta parandaluar këtë formë të krimit.

KAPITULLI I PARË

Njohuri të përgjithshme mbi trafikimin e qënieve njerëzore

1. Nocioni i trafikimit të qënieve njerëzore

Trafikimi më qenie njerëzore jo një ves apo dicka e re, por një plagë e dhimbshme, shqetësuese, nënçmimi i jetës së një njeriut, ku personat vetëm se janë drejt humbjes së dinjitetit të tyre nga kjo e keqe mizorie në përfshirjen e këtij akti kriminal, e kjo vetëm se mbetet një shpresë e dëshirë për ta larguar e harruar nga përditshmëria jonë.

Trafikimi është i njohur në gjithë rrethin global, si shkak i cili po sundon botën, në pengimin e personave drejt hapave të suksesit të tyre. Trafikimin mund ta përcaktojmë si një krim me rrezik të bollshëm, shkelje të të drejtave thelbësore të njeriut. Trafikimi me qenie njerëzore ashtu edhe sic është e njohur dhe e thënë botërisht nënkupton ‘transportim, transferim, strehim, qëllime të ndryshme, për punë të shfrytëzimit si dhe për qëllime seksuale’.¹Trafikimi me fëmijë si fenomen i mbarë botës nuk ka fund, dhe numri i trafikimit me qenie njerëzore është jashtëzakonisht i vështirë për tu matur, duke e kuptuar se ky krim është një problem shumë i madh, skandaloz dhe mjaftë i përhapur, i cili paraqitet në forma të ndryshme, për shfrytëzim të viktimës për një profit sa më të madh në vecanti te gratë dhe te qenia më e pafajshme tek fëmijët.

Trafikimi me qenie njerëzore paraqet një kaos dhe është pjesë e pandarë e shoqërisë. Nga rreziku i këtij krimi jo vetëm që ka pasoja në shëndetin fizik, por efekte të rënda anësore paraqien edhe në psiqikën, pra në shëndetin mendor, nga mundimet mizore dhe plagët e shkaktuara në mënyrë absurde. Trafikimi me qenie njerëzore vjen si fenomen transnacional, dhe me këtë shihen shkaktarë të ndryshëm, në vete me një dukuri mjaftë të rëndë. Në shumë raste trafikantët marin mbi vete apo e fitojnë kontrollin e tyre mbi viktimat, duke premtuar për një jetë

¹ Trafikimi i qënieve njerëzore, Aspekte penale juridike, krahasuese dhe kriminologjike, Naim Tota, Tirane, janar 2018

më të mirë. Me këtë krim e kuptojmë ndjesinë dhe rëndësinë e shkeljes së lirisë apo drejtës së një personi të pafajshëm. Ky krim apo kjo vepër penale tregon një numër të madh të papërshtatshëm marramendës të njerëzve të cilët janë viktimë të qënieve njerëzore.

Me trafikim të qënieve kuptuam që është ajo vepër penale e cila kryhet në mënyrë absolute kundër vullnetit të të trafikuarve, ky trafikim bëhet në formë të brendshme dhe të jashtme, ky eksploatim vazhdon në formë afatgjate që nënkupton përfitime, nga mos dëshira dhe leja e personit të trafikuar apo të shfrytëzuar. Nga e gjithë kjo sfidë e trafikimit me njerëz, që me përdorim të forcës paraqitet një akt abuzimi, konkludojmë në atë që qëllimi i trafikantëve është që personat të shfrytëzohen, të nënshtrohen, të viktimizohen dhe të përdoren në robëri apo në skllavëri, dhe në mënyra të ndryshme trafikuese i cili mund të përqendrohet në çfarë do lloje forme. Nga e gjithë ky përkufizim i nocionit të trafikimit me qenie njerëzore duhet të ndërrmarim një mision për të bërë ballë këtij krimi, duke e fuqizuar edhe më shumë gjithë iniciativën dhe veprimtarinë në botë, për mbrojtje dhe parandalim nga trafikimi me qenie njerëzore. Trafikimi me qenie njerëzore përveq që po drejton botën drejt një krize të gjithëanshme me rrezikshmërinë e saj, kërkon nevojën e kqyjes së pozitivitetit në parandalimin e këtij kriminalitetit, me një strategji të zhvilluar për të arritur në funksionim sa më të suksesshëm.

Mendoj që me strategji të bashkimit të kuadrove të ligjeve, me ndihmën e njërit shtet me tjetrin, mund të arrijmë efektin për të shuar etjen e kriminelëve për të fituar nga e keqja e dikujt tjetër mbi një sjellje mizore, dhe diqka jo të paraparë me ligj.

2. Shkaqet e paraqitjes së trafikimit me qenie njerëzore

Shkaqet e trafikimit apo arsyet e ardhjes deri tek trafikimi janë që një person apo viktima të kthehet në një shfrytëzim mjaftë fitimprurës dhe shfrytëzimi i tij të bëhet nëpërmjet kthimit në mall, pra kthim në mall në kuptimin e asaj që viktima të shfrytëzohet si mall në shitblerje. Lidhur me shkaqet, rrënjët, burimet që ndikojnë në kryerjen e krimeve, në literaturë të ndryshme përdoret emërtimi faktorë kriminogjen. Njohja e këtyre faktorëve apo shkaqeve luan rol të madh në luftimin dhe parandalimin e kriminalitetit.

Nga kjo pikënisje nënkuptohet automatikisht cënimi i të drejtës së një njeriut, duke shkelur lirit themelore të njeriut. E gjithë kjo formë tregon atë shkakun e fortë që shfrytëzimi deri në atë masë për arritjen e kënaqësisë nga fitimi i planifikuar vjen në shprehje me humbjen e identitetit dhe vlerave të atij personi apo viktimës së trafikuar. Të gjithë këto viktima më bëhen cdo ditë e më shumë vetëm se të varur dhe të shtypur nga presioni i liderëve të trafikimit. E kuptueshme që shkak i dukshëm haptazi është mendimi dhe ideja për të fituar. Për te fituar më shumë sa mund të bëhet me parramendim. Pavarësisht nga gjendjet e ndryshme ekonomike, problem e gjëra tjera, shkak për paraqitje të trafikimit me qenie njerëzore është edhe gjendja e një shteti të korruptuar, jo i drejtë, dhe transparent, dhe me një zhvillim të dobët në aspekt juridik penal.

3. Viktimat e trafikimit me qenie njerëzore

Është konstatuar se asnjëherë nuk mund të vimë në përfundim të një numri konkret të njerëzve si viktimë e trafikimit . Në shumë raste që janë hasur deri më tash si viktimë e trafikimit me qenie njerëzore fëmijet, djemë e vajza, femrat dhe meshkujt, të cilët trafikohen për lloje të shumta të trafikimit.

Shfrytëzimi ndaj këtyre viktimave bën që ata të nenshtrohen duke humbur, gjithë lirinë e tyre , dhe aftësitë e veta për mbijetese te denjë. Zakonisht kemi të bëjmë edhe me pyetjen se kush janë pjesë e shumtë si viktima të trafikimit. Jo rrallë herë viktimat e trafikimit janë persona që

vijnë nga një e kaluar problematike, e shkelur dhe pa kujdes. Janë viktimat që vetëm se përjetojnë situatë të rënde ekonomike, kur këto raste ato mashtrohen dhe detyrohen ndaj supozimeve të rrejshme për sigurim jete dhe pune në vend të panjohur. Sikur meshkujt të cilët viktimizohen në punë fizike, dhe dhune, ashtu edhe femrat e ditur ndërkombëtarisht që nënshtrohen dhe abuzohen si viktimat të dhunës seksuale. Vajzat dhe fëmijet janë viktimat që preken nga rrezikshmëria më e madhe, duke i dhunuar, duke u nënshtuar dhe frikësuar nga dominimi i fuqisë së autorëve të trafikimit. Femrat si viktimat të trafikimit trafikohen drejtpërsëdrejti nga kriminelët të organizatave kriminale, që kanë kaluar çdo përmase të fuqisë, dhe duke mbisunduar jetën e një viktime femëre. Edhe fëmijët janë pjesë e një zingjiri si ndër viktimat më të pafajshme duke u trafikuar në format e aktiviteteve të ndryshme të biznesit të trafikimit, duke i bartur Brenda dhe jashtë kufijve, si mall i blerë.

Në mbrojtje të viktimave të trafikimit janë nënshkruar traktatet ndërkombëtare për trafikim të qenieve njerëzore, ku çdo shtet i cili është pjesë e këtij traktati, së pari mundohet që ligjet, rregulloret e traktatit të jenë në ngjashmëri me legjislacionin e vendit përkatës.

4. Format kryesore të trafikimit

Trafikimi kryhet në forma të ndryshme, dhe të shumëllojshme, në varësi nga mundësia e trafikantit se për çfarë lloje trafikimi dhe përfitimi dëshiron që të arrijë, dhe në mes tyre si formë më kryesore mund të flasim për:

4.1. Punë të detyruar

4.2. Trafikim seksual

4.3. Ushtarë fëmijë

4.4. Trafikim seksual i fëmijëve

4.1 Punë e detyruar-

Cfarë nënkupton puna e detyruar dhe si e kuptojmë në një situatë të tillë, është një dilemë e madhe. Me punë të detyruar neve nënkuptojmë atë punë e cila është kundër motivit , vullnetit apo dëshirës së personit, I cili e ndjen veten të papërshtatshëm për punën të cilën obligohet që ta kryej. Një njeri apo person I cili detyrohet të punojë punë në kushte të cilat nuk janë paraparë me marrëveshje ose personi nuk I ka pranuar, kuptohet me punë nënshtrimi.

Kjo formë e kësaj veprë penale me punë të detyruar sipas shumë studimeve është njëra ndër format që edhe I jep rëndësi speciale nocionit trafikimit me njerëz. Me punë të detyruar kuptojmë apo rezultojmë në moment të ndryshëm, kur punëdhënësit I shfrytëzojnë punëtorët, duke punuar orare më të gjata nga ajo që është përcaktuar, duke punuar punë të rënda fizike , jo të mira për shëndetin, punë në ambiente të mbyllura duke mos pasur të drejtë të shfrytëzimit të pushimit, punë pa pagesa, duke mos dhënë detyrimin e duhur punëtorit, pra punë me shfrytëzime të ndryshme. Si viktimë e punës së detyruar nuk mund ti lëmë pa I cekur edhe femrat , ku në të shumtën e rasteve me pafajsinë e tyre bëhen viktimë e punës së detyruar, punë të detyruara shtëpiakë, punë të rënda fizike jashtë mase që mund ti durojë një grua, dhe më e përhapura që po lulëzon kudo në cepet e botës , shfrytëzimi seksual, në përfitime të shumta materiale.

Deri sa jemi tek trafikimi, me punë të detyruar, sot të gjithë jemi të njohur edhe me atë se viktimë e këtij lloji eksploatimi është paraqitur edhe tek meshkujt, ku ato ndërmjet ngacmimeve dhe premtive të rrejshme bien në pre të trafikimit dhe punës së detyruar. Meshkujt detyrohen që të kryejnë si zakonisht punët e rënda fizike, punë të ndryshme në ndërtimtari, duke I shfrytëzuar me punë në orare të parregullta, punë pa vonesa, punë me tortura, punë në miniera të mbyllura, duke mos lënë hapësirë për botën e jashtme. Puna e detyruar tek meshkujt ka marrë një kahje të madhe në shfrytëzimin e meshkujve në mënyrë më poshtërsuese, duke iu marrë dokumentet e identifikimit, duke humbur shenja ose gjurmë të personit në fjalë , duke mos lënë hapësirë komunikimi me rrethin apo këdo tjetër.

4.2 Trafikimi seksual

Kur arrijmë tek ky lloj trafikimi ajo që na bie ndërmend janë gratë dhe vajzat e trafikimit, është një ndër trafikimet më të përhapura me përfshirjen e grave dhe vajzave të reja të cilat rekrutohen për shfrytëzime prostitucioni, që ka marë praninë kudo në botë.

Me këtë formë krimi shfrytëzohen dhe përdoren qëllime dhe mënyra të ndryshme, qëllime për porongrafi, shfrytëzime seksuale me mashtrime online, duke l bërë femrat të besojnë në jetën më të mirë, për përfitime materiale. Trafikimi seksual bëhet me blerje të femrave nga familjet e tyre, me kërcnime, me mashtrime për sigurime të punës, mashtrime në martesë jashtë vendit, dhe si përfundim vjen në shprehje shfrytëzimi seksual dhe prostitucioni. Me trafikimin seksual , ka ardhur deri tek përhapja e prostitucionit , ku vetëm se shkon e rritet numri i prostitucionit dhe prostitutkave dhe ende nuk shihet ndërmarrje e ndonjë mase për parandalimin e këtij trafikimi.

Sa ka ndikim dhe sa është në dukje ky lloj krimi është një mendim majft i trubëllt , dhe i padefinuar. Neve e dimë që është i përhapur numër i madh i trafikimit seksual, ku vetëm se shkon e bëhet varësi negative tek të rinjtë.

4.3 Ushtarë fëmijë-

Si formë e trafikimit të fëmijëve është edhe ushtarë fëmijë, pra shërbim ushtarak i fëmijëve. Kjo formë trafikimi kryhët ndërmjet forcës, përdorjës së forcës, shfrytëzimit, udhtrim dhunë, mashtrimë, duke detyruar fëmijët pa dallim të gjinisë, qofshin djëm apo vajza, ata shfrytëzohen dhe përdorën si luftëtarë. Këto luftëtarë përdorën për punë të ndryshme, punë të detyruara të rënda fizikë. Kjo formë e krimit më fëmijë ka qënë në kyqjë dhe në pah në cdo periudhë kohorë, duke pasur parasysh së kudo anë ë mbanë në cdo cëp apo vënd të botës, shumë fëmijë pa dëshirën dhe pa pëlqimin ë tyre janë rrëmbyër më fuqi, që të shërbëjnë si ushtarë luftë.

Numër i madhë i fëmijëve shfrytëzohen në kohë të luftës në formë të ndryshme dhe në drejtime të ndryshme, që nënkupton se nuk përdoren vetëm si ushtarë luftë, por edhe në formë të rojës, shërbëtor, por më e përhapura dhe më e rrezikshmja ka qenë detyrimi ndaj një fëmije që të punojë si spiun dhe të sjell lajme.

E kuptueshme që përdorimi i fëmijëve është i ndaluar rreptësisht, me ligj në të gjitha vendet e botës. Në këtë formë të krimit me ushtarë fëmijë, bazuar në të gjitha punët të cilat ata detyrohen ti kryejnë, më e përhapura e gjithë kohërave nivelin e rrezikshmërisë e arrin pjesa e abuzimit seksual. Fëmra si një qënie ë bëkuar në moshë të një fëmijë, të cilat rrëmbëhën dhë i dëtyrojnë që më dhunë të kryjnë intimitet apo mardhënië sëksualë, më mëshkuj ushtarë. Ky krim ka peshë të rëndë, përderisa cenohet e drejta e një fëmije, si dhe cënimi moral i një femre fëmijë. Gjithë ky biznes kryhet nga një procedurë jashtë ligjore, qëllim dhe një fitim i arritur në bazë të mashtrimeve, intrigave dhe torturave.

4.4 Trafikimi seksual i fëmijëve-

Vet fjala fëmi tregon së fëmija nuk mund të jetë i vetëdijshëm për asgjë, fëmija ka botën e vet, ka botën e iluzioneve të veta, ëndërrimeve të veta, dhe qënie e pafajësisë.

Është primare dhe e kuptueshme që një fëmi nuk mund të jipet dhe të dëshiron të bëhet pjesë e një mardhënie seksuale. Vet mosha tregon që një fëmijë nuk mund të futet në një mardhënie, në një raport, apo në një akt të tillë seksual me dëshirën e vet, por kjo është vetëm se ndikim i forcës, së ushtruar mbi një fëmijë. Trafikimi seksual nënkupton gjithë mbi peshën shkatërruese, të vënë mbi fëmijët e trafikuar me qëllime seksuale, ku këto mbesin pasoja të paharruara dhe të rënda për një të mitur. Kjo e gjitha tek një fëmijë lë në mendje atë traumën psikologjike, jo rrallë herë paraqiten edhe sëmundje aftatgjate, duke i bërë edhe të nvarur nga lloje të ndryshme të substancave narkotike.

5. Pasojat e trafikimit të qënieve njerëzore

Për cdo viktimë të trafikuar me këtë llojë forme të krimit pasojat janë të rënda, mirëpo cdo viktimë i përjeton në mënyrë të ndryshme, me vuajtje të ndryshme, dhe me lënie të ndonjë pasoje negative. Të gjithë qëniet e trafikuar që janë shfrytëzuar vuajnë format e ndryshme të dëmtimeve, pra kuptohet mizoria keqbërëse ndaj tyre. Ku ata përgjatë shfrytëzimit kalojnë në faza të ndryshme , duke u futur në një traumë të thellë me shkaktimë të plota anësore. Cdo viktimë përjeton një përbuzje të jetesës, ku vjen deri në atë pikë që të humb vullnetin dhe motivin për jetesë. I gjithë shfrytëzimi lë pasojat që kushtojnë shumë rëndë më jetën. Aq shumë sa njeriu që është nën detyrim të trafikuar aq më shumë do të ketë dhimbje të vazhdueshme në cdo pjesë dhe aspekt emocional të njeriut. Nga shfrytëzimet e ndryshme viktimë në vete përmban ankthin e përjetimeve, duke i shkaktoar atë mendim që nuk mund ti përshtatet ambienteve me njerëz, duke u paraqitur probleme të shumta shëndetësore , problem psikike , duke u kufizuar dhe izoluar në vetëvete, ku unë kisha thënë se këtu mund të paraqiten jo vetëm probleme psikike standarte po probleme që mund të ndikojnë në trurin e njeriut që të bën ilozione në mendimet e tija, duke trilluar gjëra të cilat edhe nuk egzistojnë apo nuk kanë ndodhur më parë, dhe me këtë shkak komplekson nga ajo se cka do të mendojnë të tjerët për ta, edhe pse kuptohet që kjo është një e vërtetë e dhimbshme, kuptohet që gjithë këto pasoja janë si rezultat i asaj torture, dhimbje , nënvlerësimi, varësi droge, shfrytëzimi seksual, e detyrime pune, që konkludojmë në atë që tërë kjo tragjedi njeriut të trafikuar i jep ndjenjën e mosbesimit në vetëvete, dhe mos vlerësim të vetës.

Duke u bazuar në aspekt juridik , nga nevoja e shumë për një analizë e të detajuar në mbrojtje të qënieve njerëzore të trafikuar u përkrah miratimi i Konventës së OKB-së kundër krimit të Organizuar Transnacional nga viti 2000 për “mbrojtje dhe arritjen e konsenzusit global për konceptin e krimit të organizuar, unifikimin e terminologjisë dhe kërkesën që shtetet ta

penalizojnë trafikimin , dhe bashkëpunojnë në luftën kundër tij, Në nenin 2 të Konventës (“Përdorimi i Termëve “).²

Duke mos lënë anash edhe pikën cilësore të asaj se ikja nga këto pasoja është kontributi i rrethit dhe institucioneve përkatëse për këtë formë krimi. Ndiheja që duhet të japim ndaj personave të shfrytëzuar , duke bërë më maksimalen për shërimin e tyre nga e gjitha ajo që ata i mbreh mrenda shpirtit të tyre të lodhur. Pasojat e këtyre viktimave janë aq të rënda sa neve edhe nuk mund ti përshkruajmë apo ti marrim me mend se sa janë të rënda dhe të kuptueshme për personin në fjalë , dhe si ata presin të kuptohen nga opinioni për gjendjen në të cilën ata edhe ndodhen. Është e dhimbshme të kuptohet tortura që ata kanë përjetuar, duke i lënë atë pasojën që ata të kenë turp të dalin përpara familjarëve të tyre, para shoqërisë, rrethit dhe kujtëdo tjetër. Mendimet janë ata që e cmendin njeriun, evmos të flasim për në një situatë të tillë sa e sa mendime sillen rreth nesh, me faktin e asaj se si na shohni të tjerët, se sa të tjerët e kuptojnë gjendjen tonë shpirtërore. Sado që viktimat të shpëton nga ky lloj shfrytëzimi, brenda vetës përsëri do të ketë atë ndjenjën e frikës dhe ankthit e asaj që të humb gjithë motivin punues, shpresën e së ardhmes, e cila mund të shuhet për një njeri. Pasojat janë të ndryshme edhe në bazë të asaj se kujt i kryhet ky trafikimi , dhe sic e cekëm më parë cfarë lloji të shfrytëzimit, si psh. Tek femrat pasoja mund të jetë e rëndë në pikën morale ku femrat më së shumti shfrytëzohen në formë seksuale, ku ato përfundojnë në biznese të prostitucionit, dhe tek ata më të ledhatuarit e botës, ata që meritojnë dashurinë dhe lumturinë e krejt botës, janë fëmijët të pafajshmit, që pasojat nga trafikimi për ta janë shuarje e ëndërrave të një ardhmërie. Për fëmijet nuk mjaftojnë fjalët e nuk mjaftojnë kontributet e veprimet për ta, nga ajo që ata meritojnë më shumë.

Pavarësisht nga të gjitha pasojat në rend të parë , pasojë me rrezikshmëri mbetet shkelja e të drejtave të një viktime, pa dhënie të dëshirës së tij. Pasojat janë të rënda kur viktimat mbesin me emërime të ndryshme nga lloji për të cilin ata shfrytëzohen.

² Konventës së OKB-së kundër krimit të Ogranizuar Transnacional nga viti 2000

Shfrytëzimi i viktimave , i trafikimit të njerëzve, bëhet shkaktarë që pasojat ti vuan jo vetëm i trafikuari por edhe e vëndit ku bënë, që të rritet numri i vjedhjeve, rritje e papunsisë, rritje emigrimi, rritje e fuqisë së dhunës.

KAPITULLI I DYTË

Trafikimi me fëmijë

1. Llojet e trafikimit të fëmijëve

Të shumta janë rastet e trafikimeve me fëmijë, dhe normale që pa u sqaruar dhe kuptuar. Trafikimi me fëmijë ashtu sic është i neveritshëm , poashtu edhe llojet se si trafikohen janë të neveritshme, trafikimi i fëmijëve kryhet edhe në faza të ndryshme të mundëshme, ku në bazë të disa rasteve dhe studimeve thuhet se vështirë të përcaktohet një numër i saktë, sepse bazuar në disa statistika shumë fëmijë të trafikuar janë të pazbuluara. Trafikimi me fëmijë është bërë një shqetësim i gjithanshëm duke bërë kështu që shumë persona të mirren me studimin dhe hulumtimin e tij. Ai shpesh cilësohet si formë e krimit të organizuar që mund të paraqitet në lloje të ndryshme.

Nga lloje të trafikimeve kemi situatat në vazhdim:

Lypje e detyruar – këta fëmijë pamvarësisht nga mosha e tyre, pamvarësisht djem apo vajza, ata detyrohen të dalin në rrugë dhe të punojnë si lypsarë. Me këtë formë të trafikimit neve vetëm se përballemi cdo ditë në vendet tona, dhe është forma më e perhapur tek fëmijët e vegjël. Kjo formë detyrimi për fëmijët është një peshë mjaftë e rëndë, ku janë të prekur një numër i madhë fëmijësh nga ky lloj trafikimi. Fëmijët të cilët trafikohen , dhe pastaj detyrohen në lypje të detyruar, duke i shpërndarë nëpër rrugët e qyteteve, në sheshe, në kafene, pra të mundëshme në të gjithë territorin e vendit. Fëmijët të cilët shfrytëzohen në lypje të detyruar, gjatë kohës që janë të shpërndarë nëpër rrugë , ata vazhdimisht kontrollohen dhe janë në mbikqyrje që mos të bëjnë diqka jashtë urdhërit të tyre, dhe se gjithë fitimet material të dorëzohen në dore të trafikuesit, pa pasur asnjë mungesë.Me këtë problematikë të fëmijëve në lypje të detyruar ne hasim kudo që dalim, fëmijët të cilët na afrohen dhe me gjithë forcën dhe mundin e tyre na detyrojnë që tu japim të holla, por përkundrazi neve ata nuk mund ti detyrojmë që ata të japin asnjë lloj informacioni nëse i pyesim, se ku jetojnë, ku kanë prindërit, për kë po punojnë, e shumë pyetje me rrallë, ku ata aq shumë janë të pregaditur dhe të frikësuar për cfarëdolloje situatë, që nuk mund të japin asnjë pikë përgjigje. Për këtë lloj krimi apo trafikimi nevojitet , angazhim sa më

të madhë në kontrollimin e rajoneve në të gjitha pikat, për ta luftuar, dhe për ta parandaluar sa më shumë këtë llojë trafikimi, dhe cenimit të jetës së njeriut.

Krime në rrugë- fëmijët apo të miturit , shfrytëzohen në format më absurde të mundëshme, duke i detyruar fëmijët që të kryejnë krime të ndryshme dhe të rënda nëpër rrugë, duke i drejtuar në vjedhje, në shitje droge, transportime të ndryshme të mallrave. Rreziku i fëmijëve në kryerjen e këtyre krimeve të ndryshme është në formë absolute në nivel të lartë, ku siguria e shëndetit të tyre gjendet në rrezikshmëri, ku e gjithë kryerja e krimeve ilegale në rrugë tregon që privatësia dhe jeta e fëmijës nuk është në një dinamik të sigurtë.

Për kontroll të kësaj situate nevojitet strukturë më e drejtë organizative e personave përkatës për kryerjen e këtij funksioni , duke shtuar edhe më shumë vëzhgimet rajonale, dalje të rregullta në terren , identifikim të fëmijëve se kush cfarë lloji të krimit po kryen, rreziku që ata po e kalojnë. Në përgjithësi policia, apo personat që ndodhen në monitorim të situatës duhet të kenë interesin më të madhë për gjendjen psikologjike të fëmijëve, dhe se sa është i nevojshëm përkujdesja dhe shoqërimi nga mbrojtje të obligueshme nga organe, mbikqyrës apo vend i përcaktuar për këtë lloj forme krimi.

Shfrytëzimi seksual- që nga kohët e hershme edhe deri më sot shfrytëzimi seksual është në rritje të madhe. Shfrytëzimi seksual ka marrë vëmendje të madhe në gjithë globin anë e mbanë, dhe po shfrytëzohet dhe po kryhet në cdo vend të mundshëm. Shfrytëzimi seksual parashihet si biznes me përfitime mjaftë të mëdha materiale. Për trafikuesit detyrimi i femrave fëmijë në akte seksuale, është arritja e caktuar që ata e dëshirojnë. Shfrytëzimi i femrave fëmijë kryhet në cdo moment që ata gjinden në dorë të trafikantëve , ka raste kur ata mund të shfrytëzohen Brenda një nate nga shumë persona, nëpër hotele, lokale, shtëpi prostitucioni, nga meshkuj të ndryshëm , dhe e gjitha kjo sjell jo vetëm se një fitim të madhë. Ky lloj keqpërdorimi është vepër penale që dënohet si me legjislacionet shtetërore ashtu edhe me aktet e ndryshme ndërkombëtare.

Trafikimi me organe- në lidhje me këtë temë zakonisht trajtohen raste të shumta dhe tregime në kornizat e trafikimit të organeve. Trafikimi me fëmijë është e lidhur ngushtë me

trafikimin e organeve të fëmijëve , ku organizatat kriminale apo trafikuesit e këtij tregu kanë fitime të mëdha material.

Cdo ditë është rritur kërkesa dhe numri për trafikim të organeve. Ky system i trafikimit me organe më së shumti ka procedurë rrjedhëse në vendbanimet e varfura, ku trafikantët biznesin e tyre e fillojnë dhe duke e trafikuar organin në vende më të pasura më të zhvilluara ekonomisht , dhe me fitime të jashtëmase. Ky trafikim shkon si biznesi i drogës ashtu edhe me organet, shitja e organeve fillon me marrjen po rrëmbim të fëmijut, me mbytje te fëmijut, i shfrytëzojnë në nxjerrjen organeve, dhe duke i braktisur diku pa shenja jete, dhe pa shenja viktime, pa shenja ndodhie. Ajo që e dimë në jetën e përditshmërisë është që më e trafikur është veshka si organ, është veshka organ edhei kërkuar në biznes, në treg, fitimrurëse.

2. Faktorët që ndikojnë në trafikimin e fëmijëve

Faktorë kulturorë – këtu nënkuptohet mungesa edukuese dhe kulturore e fëmijëve. Ku fëmijët varet se nga çfarë rrethi shoqëror dhe ambient familjar rriten, sa është me rëndësi edukimi i fëmijës dhe rritja e tij në një nivel sa më të forte shembullor. Fëmijë të cilët jetojnë në kushtet kulturore të tilla që për traditë kanë që edhe fëmijët të punojnë për familjarët e tyre, të lëvizin larg familjeve për jetese apo martesë më të mirë , dhe nuk kanë atë nivel edukues për të përceptuar dhe kontrolluar trafikimin ndaj vetes. Shumë raste përcjellur ndër vite janë edhe si shkak i faktorëve kulturor, ku rrjedhoja e kulturës bën që fëmijët gjatë jetës së tyre ta kenë gjithmonë mbi vite atë presion apo të themi atë ide se ajo formë e jetesës së tyre, ata mendimet e tyre janë të duhurat dhe të drejta, të denja për jetesë, gjë që shkakton pikën përfundimtare trafikimin.

- Faktorë ekonomikë - ndikim i kushteve të vështira për jetese, mos kënaqësia me atë që kanë, duke mos u mjaftuar me ato kushte që jetojnë dhe dëshira për jetë më të mirë. Jetesa në kushte të vështira bën rol në shumë faktorë tjerë të paraqiten. Faktorë kyq paraqitet varfëria, dhe të

ardhurat e dobëta materiale, dhe vështirësi për tu arsimuar dhe shkolluar. Gjithë kjo parregullësi jetësore con fëmijët në një devijim jonormal, dhe shkatërues të rinisë. Në këto kushte fëmijët marrin rrugën dhe rolin e kriminelëve. Fillojnë të paraqesin sjellje kriminale, sjellje të tilla që kushtojnë shumë nga shkaktimi i pasojës. Sot kudo në botë është përhapur ky lloj faktori ekonomik, ku shumë vende të botës po vuajnë nga kriza ekonomike duke pasur parasysh ndodhitë e shumta tragjike, pandemitë, fatkeqësitë natyrore, ku këto vetëm se shkojnë dhe dobësojnë vendet, ku vjen moment i rrjedhojes së përfshirjes së trafikimit në sektorë ekonomik, pra me paraqitje të faktorëve ekonomik.

- Faktorë në mungesë të institucioneve dhe ligjeve- kjo sqaron pjesën që gati në gjithë vendet e botes, dhe rrethit shoqëror kemi mungesa të ligjeve. Mungesa e ligjit do të thotë kaos shoqëror, ku asgjë nuk kryhet në bazë të një rregulli. Në mungesë të ligjit automatikisht kuptohet mangësi e sanksioneve për formën e kryerjes së veprës penale të trafikimit me fëmijë. Mangësia e ligjit dhe institucioneve për përkrahjen e rregullave dhe të një rendi shoqëror vetëm se lehtëson mënyrën e zhvillimit të trafikimit të fëmijëve dhe qarkullim më të lirshëm dhe të pakontrolluar gjatë kalimit të vendeve kufitare. Vuajtja e mungesës së një ligji të denjë për sanksion të drejtavë të fëmijëve është edhe shkak, arsyë dhe një faktorë i fortë se pse bota sot është nën dominimin e këtij fenomeni transnacional.³

3. Luftimi, parandalimi dhe mbrojtja nga trafikimi i fëmijëve

Kuptuam që me përhapjen e këtij fenomeni, trafikimit me fëmijë, që vetëm se u bë fatkeqësi për gjithë ne, duke parë se çfarë po përjeton një viktimë fëmijë. Vuajtja e një fëmije është vuajtja e jonë, dhimbja e një shpirti të fëmijës është dhimbje e një populli, shuarja e ardhmërisë së një fëmije është shuarje e një vendi të tërë. Nga e gjithë kjo pasqyrë e këtij abuzimi

³ Trafikimi i qwnieve njerwzore, Aspektet penale juridike, krahasuese dhe kriminologjike, Naim Tota Tiranë, janar 2018
Kriminolgjia, Ragip Halili

që po e sheh bota me sy, tregohet kërkesa për luftimin, parandalimin dhe mbrojtjen e fëmijëve nga trafikimi. Që të luftohet ky fenomen nevojitet shumë faza dhe disa hapa të rëndësishme që duhet ti ndërmarrin legjislacionet e ndryshme penale, në kornizat e luftimit ndaj trafikimit me fëmijë. Është e rëndësishme që të ndërmeren shumë aktivitete, orientime, kontrole, synime, të punohet në formë dhe mënyrë absolute, në drejtim të luftimit dhe pengimit të trafikimit me fëmijë. Qëllimi kryesor apo strategjia kryesore e vendeve dhe legjislacioneve penale duhet të jetë si ta luftojnë këtë llojë krimi, pra trafikimin me fëmijë si vepër penale. Kjo tregon faktin se ky luftim nga pesha e veprës kërkon bashkimin dhe mbështetjen nga gjithë vendet, shoqëria, institucionet e ndryshme përkatëse, organizatat e ndryshme, vetëm e vetëm që përfshirja në këtë drejtim apo qëllim të jetë më e madhe. Arsyet se pse duhet të luftohet ky krim janë të shumta dhe të qarta, me kërkesë sa më shumë të një ndërgjegjësimi. Një kornizë e drejtë dhe një legjislacion i duhur është nga tiparet dhe për trajtim më adekuat dhe kryesor për ndërmarrje të reformave , më efektive ndaj parandalimit të trafikimit, si dhe me bashkëpunimin legjislativ dhe instrumenteve ndërkombëtare.

Bashkimi bën më të mirën, bashkimi bën fuqin, e fuqia bën që të luftohet mizoria, e të fiton e drejta. Për të arritur këtë të drejtë, nevojitet miratimi që kontributi i vendeve, dhe legjislacioneve të jep efektivitetin e tyre drejtë synimit të tyre në nivel të duhur.

Në luftën e trafikimit me fëmijë, duke u bazuar në Konventën e Këshillit të Evropës për Mbrojtje të Fëmijëve nga shfrytëzimi seksual dhe Abuzimi seksual është cekur që të kemi parasysh edhe “Vendimin Kuadër të Këshillit të Evropës për luftën kundër shfrytëzimit seksual të fëmijëve dhe pornografisë së fëmijëve (2004/68) “, “Vendim në Kuadër të Këshillit të Bashkimit Evropian për pjesëmarrjen e viktimave në proceset penale (2002/220). Gjithashtu këtu është parë e nevojshme të marrim parasysh edhe instrumentet në këtë fushë, Rezolutën e Asamblesë së Përgjithshme të Këshillit të Evropës S-27/2, “ Një botë e përshtatshme për fëmijët” dhe programin 3 vjeçar “Ndërtimi i një Evrope për fëmijët dhe me fëmijët” i miratuar pas samitit të 3-të dhe i prezantuar në Konferencën e Monakos (4-5 prill 2006). ⁴Por si mund të vijë deri tek parandalimi i trafikimit të fëmijëve , parandalimin e këtij biznesi, biznes i cili po sundon botën

⁴ Seritë e Traktateve të Këshillit të Evropës - nr. 201

me fitimin e saj duke u bërë i barabartë edhe me biznesin e drogës, që do të thotë fenomen i përhapur me plotë kuptimin e fjalës. Struktura për parandalim të kësaj ekzistence duhet të jetë e gjërë dhe me sërë masash reale, të dobishme, dhe me plotë rezultat dhe shumë efikasitet të lartë.

Parandalimi i trafikimit më fëmijë, nënkupton dhe tregon një thirrje publike, që mendoj dhe besoj që cdo qytetar me ndërgjëgjësinë e tij duhet të jep nga vetja kontributin e tij në këtë rrugëtim. Por jo vetëm nga ne si qytetarë, por edhe nga të gjithë organet, policinë, inspektoratët, gjithqka që është e dobishme dhe e vyerur në parandalimin e trafikimit me fëmijë.

E rëndësishme është mbrojtja e fëmijëve nga ky krim, mbështetja nga ne është zëri i mbrojtjes dhe heshtjes së fëmijëve të trafikuar, fëmijëve të shitur, fëmijëve të përdorur në punë të ndryshme torturuese, fëmijëve të abuzuar, fëmijë të cilët nuk kanë përkrahje familjare, ku nga vet anëtarët e familjes janë shitur, që të shfrytëzohen në akte seksuale, që kalojnë situatë apo sfida jo rallë herë të kapërcyeshme. Mbrojtja e fëmijëve është një start apo një detyrim specifik që duhet të ndërmeret nga gjithë ne dhe gjithë shoqëria. Në rend të parë e dimë që botërisht në formë konkrete, që shtetet duhet të jenë në mbrojtje të lirive dhe të drejtave themelore të njeriut, ku cdo njeri si qenie ka të drejtat e tij të mbrojtjes të përcaktuara me ligj.

Mbrojtja e fëmijëve mund të kryhet në forma dhe në kushte të llojllojshme, së pari duke nisur nga familjet e fëmijëve, tek cdo prind, ose kujdestarë i atij fëmijut të jetë i fokusuar dhe i përkushtuar tërësisht tek ai, mbështetje e madhe nga institucionet e duhura, apo nga shteti si funksion dhe rol kryesor, për fëmijët të cilët janë apo gjenden në shkallë rrezikshmërie, dhe me anë të ri integritetit të vijë situata deri te ulja e rrezikut, nga ndihma e vendeve përkatëse në shërbim për trajtim sa më të vlefshëm dhe efikas të fëmijëve. Bashkëpunimi brenda vendit si dhe bashkëpunimi ndërkombëtar është më se i nevojshëm kur bie fjala për mbrojtjen e fëmijëve. Mbrojtja është aq e nevojshme sa është e thellë edhe rreziku, për kategori të ndryshme të fëmijëve. Mbrojtja mund të jetë në formë të ndihmës sociale, mbrojtje ekonomike, mbrojtje nga dhuna, mbrojtje nga puna, mbrojtje e fëmijëve nga nënçmimi, e shumë e shumë shfrytëzimeve tjera. E rëndësishme tek fëmijët është mbrojtja ligjore e cila duhet të jetë falas dhe online në

gjithë priudhën , e sidomos mbrojtja ndaj shëndetit, pavarësisht gjendjes shpirtërore apo psikik ku nevojitet kontributi për rehabilitim, socializim, riintegrim.

4. Interneti dhe teknologjia

Sot më zhvillimin e madhë të teknologjisë, kryerja e krimeve cdo ditë e më shumë vetëm se po zhvendoset në mjedis digjital, ku neve kuptojmë se mënyra e kryerjes së krimit ka marrë formë të ndryshme. Mjedis digjital aq sa i ka përfitimet e veta pozitive, po aq ka edhe rreziqet, ku sot fëmijët janë grackë e vetëm një hapi larg nga devijimi, kërcnimet, nënshtrimet dhe rreziku I ndryshëm në brendësi të botës digjitale. Përderisa sot teknologjia po luan më shumë rol në trafikim, kjo vetëm se u ka mundësuar disa trafikantëve të jenë në gjendje të shfrytëzojnë të rinjtë pa u takuar ballë për ballë. Trafikantët mund të përdorin mediat sociale si një platformë për të arritur dëri tek viktimat e mundshëm me një ritëm më të shpejtë. Kjo tregon një shqetësim të jashtëzakonshëm për atë se në këto faqe interneti fëmijët janë më shumë të disponueshëm për blerje dhe shitje nga trafikantët si një produkt të tyre.

Fëmijët sot besoj që janë viktimë më e shfrytëzuar nga interneti , ku jep mundësinë që përmes internetit kryerja e krimit apo trafikimit të fëmijës të zhvillohet në një hov më të shpejtë. Rrezikshmëria e internetit është në nivel të lartë, përderisa jemi dhe flasim për fëmijët, që e meritojnë një përkujdesje të vecantë. Arsytet se pse ndikon interneti dhe mediat sociale në trafikimin e fëmijëve janë të shumta, ku këtu vlen parimi I asaj se sa fëmijët e respektojnë dhe praktikojnë rregullat në përdorimin e internetit. E rëndësishme është se sa është efektiviteti I internetit në përditshmëri, sa kushtohet vëmendje, si është qëndrimi I tyre, pra I fëmijëve përball internetit, dhe cka ndikon deri tek viktimizimi I tyre në internet. Na bëhet e ditur se kjo vjen si shkak I varësisë së fëmijëve në iluzionin me veten e tyre për një realitet tjetër në botën e mediave sociale. Më këtë lakmi dhe këtë iluzion fëmijët , sic e cekëm që bien lojë e bindjeve dhe mashtrimëve të ndryshme të trafikantëve , fillojnë ta bëjnë vërtetë nën ndikim të presionit, që ti përshtaten jetës dhe trendëve shoqërore , që orienton fëmijët drejtë humbjes së vërtetëqëndrimit,

dinjitetit, dhe të nënshtrohet ndaj një mosvlerësimi për veten. Mbas gjithë këtyre fillon ajo fazë e ngacmimëve, shfrytëzimit, që kjo pjesë fëmijët l prekë më shumë, duke l përdorur në trende dhe biznese më të rënda, apo me rrezikshmëri me peshë më të rëndë.

Dhe vimë në përfundim se e gjithë e mira e mediave sociale , ka edhe të keqën e saj se rritja e shpejtësisë apo modernizimit të kësaj jete me teknologjinë e ka lehtësuar cdo ditë e më shumë trafikimin me fëmijë, ku fëmijët duke u bërë përdorues me intensitet të lartë në internet nga rrjete të ndryshme sociale ballafaqohen në informata të rrejshme dhe nxitëse, duke mos njohur mekanizmat që ballafaqohen ndaj sjelljeve jo të përshtatshme ndaj tyre dhe duke mos e kuptuar se po në atë moment vetëm se bëhen viktimë e një trafikimi.

Ky trafikim mund të vijë atëherë ku nga fëmijët kërkohet sjellje si: ngacmime kibernetike, shkëmbim të fotografive provokuese, mesazhe eksplicite, diskriminime, fëmijët ti bindin me mashtrime të ndryshme. Përderisa cekim ngacmimet apo krimet kibernetike, janë në shfaqjen më të madhe të teknologjisë, duke e pasur parasye që teknologjitë për momentin me rrezikshmërinë e saj , edhe kanë arritur kulmin e tyre. Krimet kibernetike kanë ardhur si një problem tejet i vërtetë i rrethit tonë , në përmasa ndërkombëtare.

Vazhdueshmëria e kësaj forme është bërë pjesë e rutinës tonë , duke na kontrolluar jetën tone, apo duke zhvilluar jetesën e fëmijëve, si një fenomen i ri në kriminalitetin tone.

është një pikëpytje e madhe. Duke u nisur nga fakti se në kulm të pandemisë numër shumë I madh I fëmijëve nuk ishin brenda shkollës, ose të themi në gjithë rrethin botëror fëmijët gjindeshin jashtë bankave shkollore, dhe kjo vetëm se jep atë botëkuptim për rritje dhe lehtësim më të madhë që fëmijët të bien pre e viktimizimit, duke u përhapur edhe më tej trafikimi me fëmijë, si rrjedhojë e shumë pasojave të ndryshme. Pandemia e Covid-19 që ndikoi në nivel aq të lartë në gjendjen ekonomike, duke pasur rritje të inflacionit, rritje të papunsisë, rrënie e dukshme e numrit të personave të punësuar me të ardhura publike, paraqitje e varfërisë, borxh I rritur nga buxheti shtetërorë, mbetje mbrapa në edukim dhe lekturave shkollore, edhe pse me anë të mënyrës digjitale ishte mundësia për ndjekje të procesit mësimor, por kjo shkoi në një far rruge , apo përfshirjes së një shtate edhe më të përkeqësuar por të lehtë në trafikim. Ky aspekt I jetesës shkoi në rritje të numrit të viktimave në lehtësimin e mundësive të trafikantëve. Gjithë kjo rrëmujë e vënë në pah me pandeminë e Covid-19, shkaktarë kryesorë e cënimit të jetës së fëmijëve në mbarë botën, ku kufizimet , mbylljet dhe të gjitha bllokadat nga liria e jetesës normale , ndikoi rritshëm në gjendjen e fëmijëve që ata të bëhen edhe më lirshëm viktimë e trafikimit. Marrë nga shumë studime krahasimore dhe statistika është kuptuar që kjo gjendje ka prekur rreth " 1.6 miliardë fëmijë", dhe si faktorë kyq shihet ndikimi i mbylljes së shkollave, dhe fokusimi i fëmijëve vetëm në gjëra më të kota nga mediat sociale, dhe mashtrimet më të lehta nga trafikantët.⁶

⁶ World Bank. (2020). Global Economic Prospects, June 2020, page 5. The World Bank.
<https://doi.org/10.1596/978-1-4648-1553-9> 138 World Bank. (2020). Global Economic Prospects, June 2020, page 24. The World Bank

KAPITULLI I TRETË

Instrumentet ndërkombëtare për mbrojtjen e fëmijëve nga trafikimi

1. Konventa e të Drejtave të fëmijëve (1989)⁷

Nga veshtiresite e shumta per ndjekje te trafikimit, percaktimin e vepres penale, mbrojtjen dhe luftimin per parandalimin e trafikimit me femije eshte pare e arsyeshme miratimi I Konventave mbi trafikimin me femije.

Gjitha shtetet te cilat jane pale e kesaj Konvente, duhet te njohin te drejtat e barabarta te shoqerise, duke pasur baze kryesore lirine dhe pagen e botes. Femija si anetare njerezor I rendesishem , ne Deklaraten Universale te te Drejtave te Njeriut , Kombet e Bashkuara kane paraqitur apo shpallur qe femijet ne nje moshe me te vogel kane te drejte dhe nevojte per perkujdesje dhe perkrahje te vecante.

Ne kete Konvente mbi mbrojtje te femijeve supozohet qe te mirren te gjitha qellimet qe femija te jete me I mbrojtur , me I ruajtur , ne nje kujdes me special, nga ndeshkimet e ndryshme.

Konventa mbi te drejten e femijeve angazhon vetem se te gjitha palet per te nderrmare masa dhe iniciativa lidhur me te gjitha te drejtat e shoqerise, lidhur me kontroll te duhur kur parashihet nevoja. Gjithe anetaret ne brendesi te kesaj Konvente, pershtaten drejt zbatimit te kesaj te drejte te femijes, kontribut per ulje te vdekshmerise te femijeve apo foshnjave, per luftimin e semundjeve qe paraqiten edhe per shkak apo ndikime jo njerezore, dhe me rendesishmja siguria e ushqimit te shendetshem , pra produkte te kontrolluara nga institucione perkatese. Kisha cekur ketu , qe mbetet me mbreselenese, per ndikim tek femijet eshte zhvillimi me te larte te prinderve, pra ne keshillimin per organizim te planifikimit familjar.Kjo pike besoj eshte diqka qeduhet te

⁷ KONVENTA MBI TË DREJTAT E FËMIJËS Miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e Organizatës së Kombeve të Bashkuara më 20 nëntor 1989

mer vemendje se si jane rrjedhat familjare te nje femije, ku gjithqka nvaret edhe nga hapat e para drejt shikimit te ardhmerise jetesore.

Kuptohet qe gjithqka qe eshte vendosur apo thene ne kete Konvente, eshte caktuar vetem se me e mira e femijeve, drejtesia e femijeve, barazia , mosdiskriminimi ne mes femijeve, gje e cila edhe l vret me se shumti femijet , ku ende edhe nuk jane te vetedijshem se pse ndodh ky diskriminim, nga e cila kuptohet nje vuajtje e botes sot. Theksohet motive te mira pozitive per ta pershtatur sa me shume lumturine, gezimin, jeten , ardhmerine e femijeve, gradualisht per realizim te plote te njohjeve te te drejtave mbi femijet.

Sipas Konventës së të drejtave të fëmijëve 1989, bazuar në pikat 33, 34, 35, ceket se:

33. " shtetet Palë marrin të gjitha masat e duhura, duke përfshirë ato legislative, administrative, shoqërore dhe edukative, për të mbrojtur fëmijët nga përdorimi i paligjshëm i drogave narkotike dhe lëndëve psikotrope, siç përcaktohen në konventat përkatëse ndërkombëtare dhe për të mos lejuar që fëmijët të përdoren për prodhimin dhe trafikun e paligjshëm të këtyre lëndëve",

34. "Shtetet Palë marrin përsipër të mbrojnë fëmijën nga çdo lloj forme e shfrytëzimit seksual dhe keqtrajtimit seksual. Për këtë qëllim, Shtetet Palë marrin në mënyrë të veçantë të gjitha masat e duhura në planin kombëtar, dypalësh dhe shumëpalësh për të mos lejuar që: (a) Fëmijët të nxiten ose të detyrohen për t'u përfshirë në veprimtari të paligjshme seksuale; (b) Fëmijët të shfrytëzohen për qëllime prostitucioni ose praktika të tjera seksuale të paligjshme; (c)Fëmijët të shfrytëzohen për shfaqje ose materiale pornografike",

35." Shtetet Palë marrin të gjitha masat e nevojshme në planin kombëtar, dypalësh dhe shumëpalësh, për të mos lejuar rrëmbimin, shitjen, ose trafikun e fëmijëve për çdo qëllim dhe në çfarëdo forme qoftë".

2. Kartat e OKB-së dhe të drejtat e njeriut

Karta e OKB-së ka shprehur çdoherë shqetësim për luftën e paqes dhe për sigurinë ndërkombëtare për të drejtat dhe liritë , dhe mbrojtje të viktimave, dhe duke pasur parasysh shkeljet ndaj të drejtave të njeriut , Karta e OKB-së bazuar në qëllimet dhe parimet e veta ka marrur përsipër që të fokusohet në Nenin 1 të kësaj Karte me atë që :

“ të ruajnë paqen botërore dhe sigurinë ndërkombëtare dhe, për këtë qëllim, të marrin masa kolektive të efektshme për të parandaluar dhe mënjeluar kërcënimet e paqes, për të mposhtur veprimet mësymëse dhe shkeljet e tjera të paqes, si dhe për të zgjidhur me mjete paqësore sipas parimeve të drejtësisë dhe të drejtës ndërkombëtare konflikte ndërkombëtare apo situata, që do të mund të çonin në shkelje të paqes dhe të zhvillojnë marrëdhënie miqësore mes kombeve, të cilat bazohen në parimet e barazisë dhe të vetëvendosjes së popujve si dhe të marrin masa të tjera të përshtatshme për konsolidimin e paqes të ngrenë në këmbë një bashkëpunim ndërkombëtar për të zgjidhur probleme ndërkombëtare të natyrës ekonomike, sociale, kulturore dhe humanitare si dhe për të mbështetur dhe forcuar respektimin e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut për të gjithë, pa dallim race, seksi, gjuhe apo besimi fetar” ;

“ të jenë qendra, në të cilën koordinohen me njëra-tjetrën përpjekjet e kombeve për të realizuar këto qëllime të përbashkëta ”⁸

Karta e OKB-së jep mbështetje dhe fuqi edhe në drejtim të aktiviteteve në fushën ekonomike dhe sociale duke dhënë përkufizim dhe përpjekje në mbështetje të stabilitetit dhe strategjisë për nevojën e paraparë për mirëqenje më bekuar ndaj lirive themelore, mbështetur në Nenin 55 Të kësaj Karte të OKB-së në vijim se:

“përmirësimin e standardeve të jetesës, punësimin e plotë dhe krijimin e kushteve për progres dhe rritje ekonomike e sociale në zgjidhjen e problemeve ndërkombëtare të natyrës ekonomike, sociale, shëndetësore dhe të ngjashme me to si dhe bashkëpunimin ndërkombëtar në fushën e

⁸ Karta e Kombeve të Bashkuara [nënshkruar në datën 26 qershor 1945 në San Francisko; hyrë në fuqi në datën 24 tetor 1945]

kulturës dhe edukimit dhe respektimin e përgjithshëm dhe realizimin e të drejtave të njeriut dhe lirive themelore për të gjithë njerëzit pa dallim race, gjinie, gjuhe dhe besimi fetar”.⁹

Karta e Kombeve të Bashkuara [nënshkruar në datën 26 qershor 1945 në San Francisko, hyrë në fuqi në datën 24 tetor 1945 në Preambulë të saj ka të theksuar pjesën më tërë të

“ NE, POPUJT E KOMBEVE TË BASHKUARA , të vendosur të mbrojmë brezat e ardhshëm nga kamxhiku i luftës, i cili në ditët tona ka sjellë dy herë vuajtje të pathëna mbi njerëzimin, të forcojmë sërish besimin tonë në të drejtat themelore të njeriut, në dinjitetin dhe vlerat e personalitetit njerëzor, në barazinë mes burrit dhe gruas si dhe mes gjithë kombeve, qofshin këto të mëdha a të vogla”¹⁰

⁹ Karta e Kombeve të Bashkuara [nënshkruar në datën 26 qershor 1945 në San Francisko; hyrë në fuqi në datën 24 tetor 1945

¹⁰ Karta e Kombeve të Bashkuara [nënshkruar në datën 26 qershor 1945 në San Francisko; hyrë në fuqi në datën 24 tetor 1945]
Karta e Kombeve të Bashkuara (1945)

<https://dreitesia.gov.al/wp-content/uploads/2019/03/KARTA-E-KOMBEVE-TE-BASHKUARA-1.pdf>

3. Konventa Evropiane e të drejtave të njeriut- për mbrojtjen e fëmijëve

Duke I pasur parasysh gjitha instrumentet e tjera ndërkombëtare për luftimin e trafikimit më fëmijë dhe pengimin ndaj torturës së fëmijut, dhe dhënie maskimale mbrojtje të fëmijut, për të shijuar liritë ë veta , si “Deklaratën e Stokholmit dhe Axyhendën për Veprim, miratuar në Kongresin e Parë Botëror kundër Shfrytëzimit Tregtar Seksual të Fëmijëve (27-31 gusht 1996), Angazhimin Global të Jokohamas, miratuar në Kongresin e dytë Botëror Kundër Shfrytëzimit Komercial Seksual të Fëmijëve (17-20 dhjetor 2001), Angazhimin e Budapestit dhe Planin e Veprimit, miratuar në Konferencën përgatitore për Kongresin e dytë Botëror kundër Shfrytëzimit Tregtar Seksual të Fëmijëve (20-21 nëntor 2001), Rezolutën e Asamblesë së Përgjithshme të Këshillit të Evropës S-27/2 “Një botë e përshtatshme për fëmijët” dhe programin 3-vjeçar “Ndërtimi i një Evrope për Fëmijët dhe me Fëmijët”, i miratuar pas Samitit të 3-të dhe i prezantuar në Konferencën e Monakos (4-5 prill 2006)”.

Qëllimi kryesor I Konventës është që të punon më shumë drejt nxitjes dhe anulimit të shfrytëzimit së fëmijëve në abuzime seksuale dhe shfrytëzimë seksuale të ndryshme. Të ulet niveli I shfrytëzimit të keqpërdorimit fëmijëve jo kaq mizorie, dhe heqje e drejtave.

Ndarja dhe monitormi Konventës sqaron rregullsin, detajimin dhe efektin e mbrojtjes , se cka do te thotë fëmi.

Konventa Evropiane perkufizon:

*“fëmijë” është çdo person nën moshën 18 vjeç, shfrytëzimi seksual dhe abuzimi seksual i fëmijëve, përfshin sjelljen e përshkruar nga neni 18 deri në nenin 23 të Konventës, “viktimë” është çdo fëmijë që është objekt i shfrytëzimit seksual ose i abuzimit seksual”.*¹¹

Nevoja e mbrojtjes fëmijëve detyrë e palëve , obligim, strategji , e pikave ndihmëse :

¹¹ Konventa e Këshillit të Evropës për Mbrojtjen e Fëmijëve nga Shfrytëzimi Seksual dhe Abuzimi Seksual, Seritë e Traktateve të Këshillit të Evropës - nr. 201, Lanzarote, 25. X. 2007

*“Çdo palë merr masat e nevojshme legislative ose masa të tjera për të ndihmuar viktimat, në kuadrin afatshkurtër dhe afatgjatë, për rimëkëmbjen e tyre fizike dhe psikosociale. Masat e marra në përputhje me këtë paragraf duhet të marrin parasysh pikëpamjet, nevojat dhe shqetësimet e fëmijëve. Çdo palë merr masa, sipas kushteve të parashikuara nga legjislacioni i brendshëm, për të bashkëpunuar me organizatat jo-qeveritare, organizata të tjera përgjegjëse ose me elementë të shoqërisë civile të përfshirë në ndihmën ndaj viktimave. Në rastet kur prindërit ose personat që kujdesen për fëmijët përfshihen në shfrytëzimin seksual ose abuzimin seksual të fëmijës, procedurat ndërhyrëse të marra në zbatim të” Nenit 11, paragrafi 1, përfshijnë: – “mundësinë e largimit të autorit të supozuar të aktit; – mundësinë e largimit të viktimës nga mjedisi i tij/saj familjar”. Kushtet dhe kohëzgjatja e largimit përcaktohet në përputhje me interesin më të madh të fëmijës. Çdo palë merr masat e nevojshme legislative ose masa të tjera për t’u siguruar se personat që janë afër me viktimën mund të përfitojnë, në rastet kur është e nevojshme, ndihmë terapeutike, veçanërisht ndihmë emergjente psikologjike”.*¹²

4. Protokolli Opsional i Konventës për të drejtat e fëmijëve mbi shitjen e fëmijëve, prostitucion me fëmijë¹³

Nga gjithë instrumentet ndërkombëtare në mbrojtjen e fëmijëve , është parë I arsyeshëm edhe Protokolli Opsional I Koventës për të drejtat e fëmijëve mbi shitjen e

¹² CETS 201 – Mbrojtja e Fëmijëve nga Shfrytëzimi Seksual dhe Abuzimi Seksual, 25.X.2007

<https://rm.coe.int/168046e1e3>

¹³ OPTIONAL PROTOCOL TO THE CONVENTION ON THE RIGHTS OF THE CHILD ON THE SALE OF CHILDREN, CHILD PROSTITUTION AND CHILD PORNOGRAPHY Volume 2171, A-27531

OPTIONAL PROTOCOL TO THE CONVENTION ON THE RIGHTS OF THE CHILD ON THE SALE OF CHILDREN, CHILD PROSTITUTION AND CHILD PORNOGRAPHY Volume 2171, A-27531

Adopted and opened for signature, ratification and accession by General Assembly resolution A/RES/54/263 of 25 May 2000. It entered into force on 18 January 2002.

ëmijëve, dhe prostitucion me fëmijë, që fëmija të mbrohet nga shfrytëzime të pornografisë së fëmijëve, dhe e cila është ndarë në nene për qartësim, të caktuar :

“Shtetet Palë do të ndalojnë shitjen e fëmijëve, prostitucionin e fëmijëve dhe pornografinë e fëmijëve siç parashikohet nga ky Protokoll”.

Për qëllime të këtij Protokolli:

“Shitja e fëmijëve nënkupton çdo veprim ose transaksion me anë të të cilit një fëmijë transferohet nga ndonjë person ose grup personash te tjetri për shpërblim ose ndonjë kompensim tjetër, Prostitucioni i fëmijëve nënkupton përdorimin e një fëmije në aktivitete seksuale me shpërblim ose çdo formë tjetër vlerësimi, Pornografia e fëmijëve nënkupton çdo përfaqësim, me çfarëdo mjeti, të një fëmije të përfshirë në aktivitete seksuale reale ose të simuluar ose çdo përfaqësim të pjesëve seksuale të një fëmije për qëllime kryesisht seksuale”.

“Asgjë në këtë Protokoll nuk do të prekë asnjë dispozitë që është më e favorshme për të realizimin e të drejtave të fëmijës dhe që mund të përfshihen në:

(a) Ligji i një Shteti Palë;

(b) E drejta ndërkombëtare në fuqi për atë shtet”.

5. Protokoll i Palermos – mbi parandalimin, shtypjen dhe ndëshkimin e trafikimit me fëmijë

Ky protokoll mbi parandalim, shtypje dhe ndëshkimin e trafikimit me fëmijë tregon një material mjaftë kompletues dhe deklaron një efekt pozitiv në mbrojtje të fëmijëve, tregëtisë me njerëz . Ky protokoll do të veprojë dhe bashkëpunojë së bashku me Konventën, në luftim të trafikimit.

Neni 6 — Ndihma dhe mbrojtja e viktimave të trafikimit të qenieve njerëzore

“ Në rastet e duhura dhe për aq sa është e mundur sipas legjislacionit të tij të brendshëm, çdo Shtet Palë do të mbrojë privatësinë dhe identitetin e viktimave të trafikimit të personave, duke përfshirë, ndër të tjera, duke i bërë konfidenciale procedurat ligjore në lidhje me një trafikim të tillë. Çdo Shtet Palë do të sigurojë që sistemi i tij ligjor ose administrativ i brendshëm të përmbajë masa që u ofrojnë viktimave të trafikimit të personave, në rastet e duhura: Informacion mbi procedurat përkatëse gjyqësore dhe administrative, Asistencë për të mundësuar paraqitjen dhe shqyrtimin e pikëpamjeve dhe shqetësimeve të tyre në fazat e duhura të procedimit penal kundër autorëve, në një mënyrë që nuk cenon të drejtat e mbrojtjes. Çdo Shtet Palë do të shqyrtojë zbatimin e masave për të siguruar rikuperimin fizik, psikologjik dhe social të viktimave të trafikimit të personave, duke përfshirë, në rastet e duhura, në bashkëpunim me organizatat joqeveritare, organizata të tjera përkatëse dhe elementë të tjerë të shoqërisë civile, dhe, në veçanti, dispozita e: strehim të përshtatshëm, Këshillim dhe informacion, veçanërisht në lidhje me të drejtat e tyre ligjore, në një gjuhë që mund ta kuptojnë viktimat e trafikimit të qenieve njerëzore, Ndihma mjekësore, psikologjike dhe material, Mundësitë e punësimit, arsimimit dhe trajnimit. Çdo Shtet Palë do të marrë parasysh, në zbatimin e dispozitave të këtij neni, moshën, gjininë dhe nevojat e veçanta të viktimave të trafikimit të qenieve njerëzore, në veçanti nevojat e veçanta të fëmijëve, duke përfshirë strehimin, arsimimin dhe kujdesin e duhur. Çdo Shtet Palë do të përpiqet të sigurojë sigurinë fizike të viktimave të trafikimit të qenieve njerëzore ndërsa ato janë brenda territorit të tij. Çdo Shtet Palë do të sigurojë që sistemi i tij ligjor i brendshëm të përmbajë masa që u ofrojnë viktimave të trafikimit të personave mundësinë për të marrë kompensim për dëmin e pësuar”.¹⁴

¹⁴ <https://www.ohchr.org/en/instruments-mechanisms/instruments/protocol-prevent-suppress-and-punish-trafficking-persons>

Protocol to Prevent, Suppress and Punish Trafficking in Persons Especially Women and Children, supplementing the United Nations Convention against Transnational Organized Crime, 15 November 2000, General Assembly resolution 55/25

6. Deklarata e Brukselit për pengimin e trafikimit

Në këtë Deklaratë janë të rregulluara në përgjithësi aspektet juridiko- penale me qëllim për ndërrmarur masa konkrete, ne mbrojtje të viktimave të tregtisë me njerëz , dhe kushtet më të mira për luftim dhe pengim të tregtisë me njerëz.

Duke u përpjekur që në përgjithësi të rregullohen gjitha aspektet ndihmëse në luftimin e tregtisë me njerëz, Deklarata ka dispozitat e saja me theks të pikës 14: *“ viktimat të cilat pajtohen ë bashkëpunojnë në sistemin e drejtësisë penale duhet të kenë domosdo qasje te lejet afatshkurtra për qëndrim. Zbatimi i lejes të këtillë për qëndrim duhet doemos me vëmendje të ndiqet dhe të vlersohet, me qëllim të pengimit të rasteve “ të tregtimit” , me të cilat varroset kapaciteti i vendosjes dhe përkrahjes së viktimave të vërteta për shkak të ankesave nga viktimat ë rrejtshme. Gjithashtu , viktimat duhet të ketë të drejtë të ankesës kundër vendimeve të organeve administrative dhe gjyqësore të miratuara në lidhje me vendimet afatshkurtra për qëndrim”*.¹⁵

Pjesa e 7 tregon - PARANDALIMI I TRAFIKIMIT ME NJERËZ

Shkaqet rrënjësore

“ Një aspekt thelbësor i një qasjeje të bazuar në të drejtat e njeriut ndaj trafikimit të qenieve njerëzore është vendosja theksimi në perspektivat gjinore. Një strategji evropiane kundër trafikimit duhet të përfshijë luftimi i dhunës me bazë gjinore dhe strukturave patriarkale që nxit një favorizues mjedisi për trafikim , legjislacioni dhe politikat për mundësi të barabarta duhet të mbrojnë dhe forcojnë atë juridik dhe social, pozitën e grave dhe fëmijëve dhe në mënyrë specifike adresojnë të gjitha format e diskriminimit gjinor dhe duhet të krijohen programe mbështetëse që synojnë pjesëmarrjen dhe fuqizimin e plotë “

¹⁵Kriminaliteti I organizuar – Aspektet juridike , Tanja Kikerekova, Tetovë , 2009

12. Rekomandime specifike për parandalimin e trafikimit të fëmijëve

“Cënueshmëria dhe nevojat e veçanta të viktimave të trafikuar të fëmijëve janë të njohura dhe të sanksionuara nga e drejta ndërkombëtare dhe kombëtare. Kjo duhet të pasqyrohet qartë edhe në praktikë. Për të reduktuar incidenca e trafikimit të fëmijëve, duhet të zbatohen veprime specifike si p.sh. në fushën e rregulloret për pasaportat dhe vizat, duke përfshirë mundësinë për të kërkuar që të gjithë fëmijët mbi moshën pesë duhet të kenë pasaportën e tyre dhe zgjatjen e kohës së paraqitjes për vizë aplikimet në lidhje me fëmijët për të lejuar hetimin e sfondit në origjinë dhe destinacion vende. Përfshirja e biometrisë në dokumentet e lëshuara të udhëtimit do të kontribuojë për më mire identifikimin e fëmijëve të trafikuar dhe të zhdukur. Një masë tjetër e rëndësishme është të kërkohet transportues agjentët për të ruajtur identitetin dhe dokumentet e udhëtimit të të miturve të pashoqëruar dhe atyre të fëmijët që shoqërohen, por jo nga një anëtar i afërt i familjes që mund të dorëzohet më pas në posedim të autoriteteve të imigracionit në pikën e mbërritjes. Përveç kësaj, hulumtimi dhe zhvillimi i sistemeve për regjistrimin e fëmijëve mund të kontribuojë në parandalimin e trafikimi i fëmijëve sapo të vendoset”.¹⁶

7. Konventa kundër Krimit të Organizuar- Protokolli shtesë për ndalim të trafikimit me fëmijë

KONVENTA kundër Krimit të Organizuar ka për qëllim zhvillimi e mëtëjshëm të masave të ndërmarrura për luftën ndaj krimit të organizuar si një problem kyq transnacional. Konventa kundër krimit të organizuar merret me pengimin e përhapjes se krimit të organizuar dhe lënjes së pasojave , me zbatim të mekanizmave e standarteve për ndihmë dhe ndjekje e rasteve.

¹⁶ <https://www.refworld.org/docid/4693ac222.html>

COUNCIL OF THE EUROPEAN UNION Brussels, 29 November 2002 14981/02 LIMITE JAI 280 SOC 572
Delegations will find attached the Brussels Declaration made at the European Conference on Preventing and Combating Trafficking in Human Beings - Global Challenge for the 21st Century - on 18 to 20 September 2002.

Kjo Konventë ka edhe Protokolli shtesë të parandalimit të trafikimit me fëmijë- **PROTOKOLLI MBI PARANDALIMIN, PENGIMIN DHE NDËSHKIMIN E TRAFIKUT TË PERSONAVE, VEÇANËRISHT TË GRAVE DHE FËMIJËVE, NË PLOTËSIM TË KONVENTËS SË KOMBEVE TË BASHKUARA KUNDËR KRIMIT TË ORGANIZUAR NDËRKOMBËTAR** duke pas të ditur faktin se mungesa luftës për fëmijë është e madhe ky protokoll thekson dhe rezulton në faktin :

“Duke rikujtuar rezolutën e Asamblesë së përgjithshme 53/111 të Dhjetorit 1998, në të cilën Asambleja vendosi të krijojë një komitet ad-hoc ndërqeveritar afatgjatë (apenended) të hapur me qëllim të përpunimit të një konvente të plotë ndërkombëtare në lidhje me luftën kundër krimit të organizuar ndërkombëtar dhe për të diskutuar përpunimin, ndër të tjera, të një instrumenti ndërkombëtar që do t'i adresohet trafikut të grave dhe fëmijëve, Të bindur se plotësimi i Konventës me një instrument ndërkombëtar për parandalimin, pengimin dhe ndëshkimin e trafikut të personave, veçanërisht të grave dhe fëmijëve, do të jetë i dobishëm në luftën kundër këtij krimi”

Dhe me anë të këtij instrumenti përkufizohet mbrojtja me anë të qëllimit të këtij Protokolli

“pëlqimi i viktimës së trafikut për shfrytëzimin e qëllimshëm, Rekrutimi, transportimi, transferimi, fshehja ose pritja e një fëmije për qëllime shfrytëzimi, do të konsiderohet “trafik personash” edhe nëse në të nuk do të përfshihen mjetet e parashikuara, “Fëmijë” nënkupton çdo person nën 18 vjeç”.¹⁷

¹⁸ Në ndarjen e pjesëve në këtë protokoll si parim të rëndësishëm është detajuar edhe PARANDALIMI, BASHKËPUNIMI DHE MASAT TJERA , Neni 9 sqaron” **Parandalimi i trafikut të personave”:**

¹⁷ http://jus.igik.rks-gov.net/747/1/160813_Konventat%20finale_final%20version_shqip.pdf

¹⁸ http://jus.igik.rks-gov.net/747/1/160813_Konventat%20finale_final%20version_shqip.pdf

<https://www.infocip.org/al/?p=3658>

https://www.pp.gov.al/rc/doc/konventa_e_kombeve_te_bashkuara_kunder_krimet_te_organizuar_nderkombetar_774.pdf

Ligj nr. 8920 datë 11.7.2002 Për ratifikimin e “Konventës së Kombeve të Bashkuara kundër krimit të organizuar ndërkombëtar” dhe dy protokolleve shtesë të saj

“për të parandaluar dhe luftuar trafikun e personave, për të mbrojtur personat e trafikuar, veçanërisht fëmijët, nga riviktimizimi, Shtetet Palë, duhet të ndërmarrin ose të forcojnë masat, duke përfshirë ato nëpërmjet bashkëpunimit, dypalësh ose shumëpalësh, për të reduktuar faktorët që i bëjnë personat, veçanërisht gratë dhe fëmijët, të bëhen viktima të trafikut, siç janë varfëria, zhvillimi i pakët dhe mungesa e mundësive të barabarta, duhet të adaptojnë ose forcojnë masat legjislative ose masat tjera, siç janë edukimi, masat sociale e kulturore, duke përfshirë ato që rrjedhin nga bashkëpunimi, dypalësh e shumëpalësh, për të mos inkurajuar kërkesën që nxit të gjitha format e shfrytëzimit të personave, veçanërisht të grave dhe fëmijëve, që i çon ata drejt trafikut”¹⁹

¹⁹ Konventa e Kombeve të Bashkuara kundër Krimit të Organizuar Ndërkombëtar dhe dy Protokollet Shtesë të Saj PROTOKOLLI MBI PARANDALIMIN, PENGIMIN DHE NDËSHKIMIN E TRAFIKUT TË PERSONAVE, VEÇANËRISHT TË GRAVE DHE FËMIJËVE, NË PLOTËSIM TË KONVENTËS SË KOMBEVE TË BASHKUARA KUNDËR KRIMIT TË ORGANIZUAR NDËRKOMBËTAR

KAPITULLI I KATËRT

Vështrim krahasues i disa legjislacioneve bashkëkohore lidhur me trafikimin e fëmijëve

1. Trafikimi me fëmijë në Afrikë

Në shikim të të gjitha fushave Afrika është vend problematik në shumë sfera, por përfshirë edhe në kriminalitetin e trafikimit me fëmijë. Në afrikë një numër i madh i popullsisë mban pjesën e fëmijëve, ku është pjesa më e prekur nga varfëria dhe mungesë e arsimimit. Afrika së pari është e njohur ndërkombëtarisht me kushtet ekonomike me të cilat ballafaqohen fëmijët e shumë zonave, ku në përditshmërinë e tyre zhvillimi është i mangët , ku ato cdo ditë përballen apo bin në konflikt me mënyrën se si jetojnë, që numër i fuqishëm i fëmijëve janë dëshmitar të trafikimit, formës së shfrytëzimit të tyre, dhe dhunës.

Arsyet se pse numri i lartë i trafikimit ndaj fëmijëve janë të shumta, problemet familjare, dhuna në familje, martesat e hershme, konfliktet, papunsia, fëmijët pa mbrojtje, pa strehje, pa këshillë edukate, ku vetëm se përmes kësaj ane ushqehet dhe jipet material për trafikim të lirë. Edhe për vendin e Afrikës fëmijët e trafikuar janë problematikë tejet serioze, ngaqë trafikimi i fëmijëve ka kaluar cdo limit për dallim trafikimit me femra apo me meshkuj.

Shumë vende në Afrikë janë vende të shkatëruara dhe pa kontrolle, me c'rast fëmijët trafikohen në llojë të ndryshme, numër i madh i fëmijëve shiten apo trafikohen si skllëvër , në shfrytëzim të punëve ilegale. Fëmijët femra në Afrikë janë në qëndrueshmëri të madhe të trafikimit të punojnë në drejtim të prostitutave dhe shfrytëzime seksuale. Afrika ka shumë të rritur kërkesën për të trafikuar fëmijë, kërkesë për ti dërguar në konflikte, fëmijë në detyrime ushtarake , dhe jashtëzakonisht përfshirja për trafikim të organeve të fëmijëve ka arritur në një cak tejet jashtë njerëzore. Kjo formë e trafikimit të fëmijëve me qëllim për tregti organesh ,

detyron tutorët deri tek vrasja e fëmijëve për ti përdorur dhe shitur organet e tyre, ne fitim të një shume parash në përqindje boll të madhe.

Duke e parë gjendjen e rëndushme të Afrikës, shumë legjislacione kanë folur për masat që duhet ti ndërmer Afrika në mbrojtje të vendit dhe fëmijëve, duke e pasur të ditur se janë shkelur dhe cenuar të drejtat e fëmijëve. Për gjendjen rënduese të trafikimit me fëmijë në Afrikë ka shprehur edhe drejtori ekzekutiv i Unicef se “ Trafikimi është ndër shkeljet më të këqija të të drejtave të fëmijëve”.

Për mbrojtje të fëmijëve dhe për të drejtat e fëmijëve mbështetjë jep edhe, CRIMINAL LAË (SEXUAL OFFENCES AND RELATED MATTERS) AMENDMENT ACT 32 OF 2007 - VEPRIMET SEKSUALE KUNDËR FËMIJËVE –

Pjesa e parë:

Aktet seksuale konsensuale me fëmijë të caktuar

- *“Veprat e depërtimit seksual me konsensus me fëmijë të caktuar (përdhunim ligjor)”*
- *“Aktet e shkeljes seksuale konsensuale me fëmijë të caktuar (seksuale statutore sulm)”*

Pjesa e dytë:

Shfrytëzimi seksual dhe kujdesi seksual i fëmijëve, ekspozimi ose shfaqja ose shkaktimi

ekspozimi ose shfaqja e pornografisë ose pornografisë së fëmijëve për fëmijët dhe përdorimi i fëmijëve për qëllime pornografike ose përfitim nga pornografia e fëmijëve

- *“Shfrytëzimi seksual i fëmijëve”*
- *“Kujdesi seksual i fëmijëve”*
- *“Ekspozimi ose shfaqja ose shkaktimi i ekspozimit ose shfaqjes së pornografisë së fëmijëve apo pornografi për fëmijët”*

- “Përdorimi i fëmijëve për ose përfitimi nga pornografia e fëmijëve”²⁰

Pjesa e tretë:

Detyrimi ose shkaktimi i fëmijëve për të dëshmuar ofendime seksuale, akte seksuale ose vetëmasturbim dhe ekspozim ose shfaqje ose shkaktim të ekspozimit ose shfaqjes së organeve gjenitale organet, anusi ose gjinjtë e femrës ('fletëzues') të fëmijët

- “Detyrimi ose shkaktimi i fëmijëve për të dëshmuar shkelje seksuale, akte seksuale ose vetëmasturbim”

- “Ekspozimi ose shfaqja ose shkaktimi i ekspozimit ose shfaqjes së organeve gjenitale, anusi ose gjinjtë e femrës tek fëmijët ('duke ndezur')”

Kapitulli 4 :

VEPRIMTARI SEKSUALE KUNDËR PERSONAVE TË KUFIZUARA ME TË KUFIZUARA MENDORË

Shfrytëzimi seksual dhe kujdesi seksual i, ekspozimi ose shfaqja ose shkaktimi i ekspozimit ose shfaqja e pornografisë së fëmijëve ose pornografisë për personat me aftësi të kufizuara mendore dhe përdorimi i personave me aftësi të kufizuara mendore për qëllime pornografike ose përfitime prej saj:

- “Shfrytëzimi seksual i personave me aftësi të kufizuara mendore”

- “Kujdesi seksual i personave me aftësi të kufizuara mendore”

- “Ekspozimi ose shfaqja ose shkaktimi i ekspozimit ose shfaqjes së pornografisë së fëmijëve ose pornografi për personat me aftësi të kufizuara mendore”

²⁰ (2002). Child Trafficking in West Africa - Policy Responses, *Innocenti Insights* no. 7

-“ Përdorimi i personave me aftësi të kufizuara mendore për qëllime pornografike ose duke përfutur prej saj”.²¹

Edhe Afrikën e kaploi ndikimi i pandemisë Covid-19, që e mori uljen e kontrollit shtetëror dhe rritje të kriminalitetit, duke pasur ndikim në suaza të brendshme territoriale. Trafikimi me fëmijë vetëm se dha fluks të madh të zhvillimit, duke përforcuar dhe ritur profesionin trafikues në kufijt e vendit të tyre.

Si shumë shtete dhe vende tjera edhe Afrika ka të nënshkruar , apo të ratifikuar **Protokollin e Palermos**, për ndihmë ndaj akteve kriminale , për mbrojtje të të drejtave të fëmijëve, privatësisë së fëmijëve, pra për liritë themelore të një fëmiju.

2. Trafikimi me fëmijë në Gjermani

Gjermania ka bërë bujë të madhe duke konsoliduar në atë se Gjermania një shtet mjaftë i zhvilluar në gjithë aspektet pati mangësi në kontrollim të trafikimit, në bazë të gjitha mundësive për eliminim formës së trafikimit. Si faktor kyq paraqitet edhe Covid-19 , që me peshën e saj ndikoi që shteti gjerman të mbetet në nivel të ulët për të dominuar me këtë kaos dhe për ta kontrolluar trafikimin. Dhe me analizat e shumta duke kuptuar që edhe Gjermania po sundon me trafikim e fëmijëve, janë sqaruar rekomandime të shumta për një zbatueshmëri të drejtë të këtij fenomeni. Edhe pse shteti gjerman has vështirësi në këtë temë, nga arsyeja se Brenda në vend ka një numër të dendur me ardhjen e të huajve, dhe kjo jashtëzakonisht është jashtë mundësive të kontrollit adekuat. Edhe në Gjermani trafikimi me fëmijë kryhet në të gjitha format e mundëshme, me përmasa rritura në shfrytëzim seksual të fëmijëve. Por kjo nuk nënkupton atë

²¹ CRIMINAL LAW (SEXUAL OFFENCES AND RELATED MATTERS) AMENDMENT ACT 32 OF 2007

(English text signed by the President) published in GG 30599 of 14 December 2007

<https://www.unicef-irc.org/404.php>

që shteti gjerman nuk është ngritur drejt iniciativave gjithë shtetërore dhe Gjermania me fuqinë e saj e njohur ndërkombëtarisht, tregohet luftarake dhe tregohet një fushë tejet e gjërë për menaxhimin e trafikimit me fëmije. Gjermania gjatë gjithë kohës muret me luftimin dhe parandalim të kësaj formë të kriminalitetit gjithëpërfshirës, ku edhe në cdo mundësi qeveria dhe institucionet në Gjermani kanë provuar përpjekje të ndryshme në ligjet, ndaj kësaj veprë penale.

Neni 176

Abuzimi seksual i fëmijëve

“Kushdo që kryen akte seksuale ndaj një personi nën 14 vjeç (fëmijë) ose e detyron fëmijën të kryejë akte seksuale ndaj tyre, dënohet me burgim nga gjashtë muaj deri në 10 vjet. Kushdo që detyron një fëmijë të kryejë akte seksuale ndaj një personi të tretë ose që personi i tretë të kryejë akte seksuale ndaj fëmijës, dënohet me të njëjtin dënim. Në raste veçanërisht të rënda, dënimi është me burgim së paku një vit. Kushdo që kryen akte seksuale në prani të fëmijës, bën që fëmija të kryejë akte seksuale, përveç rastit kur akti i nënshtrohet një dënimi sipas nënseksionit (1) ose nënseksionit (2), influencon një fëmijë me anë të materialit (seksioni 11 (3)) ose teknologjive të informacionit dhe komunikimit me qëllim që të detyrohet fëmija të kryejë akte seksuale mbi ose në prani të dhunuesit ose të një personi të tretë ose që dhunuesi ose një person i tretë të kryejë akte seksuale ndaj fëmijës ose influencon një fëmijë duke shfaqur imazhe ose përshkrime pornografike, duke luajtur regjistrime audio pornografike, duke vënë në dispozicion përmbajtje pornografike nëpërmjet teknologjive të informacionit dhe komunikimit ose të folurit pornografik dënohet me burgim nga tre muaj deri në pesë vjet. Kushdo që ofron ose premtan furnizimin e një fëmije për një shkelje sipas nënparagrafëve (1) deri në (4) ose që merr masa me një tjetër për të kryer një veprë të tillë, dënohet me burgim nga tre muaj deri në pesë vjet. Tentativa është e dënueshme; kjo nuk zbatohet për veprat sipas nënseksionit (4) nr. 3 dhe 4 dhe nënseksionin (5)”.

Seksioni 176 –a Abuzimi seksual i rënduar i fëmijëve

“Abuzimi seksual i fëmijëve në rastet nga neni 176 (1) dhe (2) dënohet me burgim për një periudhë prej së paku një vit nëse shkelësi është dënuar për një veprë të tillë me aktgjykim të formës së

prerë në afatin e mëparshëm pese vite. Abuzimi seksual i fëmijëve në rastet nga neni 176 (1) dhe (2) dënohet me burgim prej së paku dy vjet, nëse një person mbi 18 vjeç kryen marrëdhënie seksuale me fëmijën, ose kryen akte të ngjashme seksuale ndaj fëmijës ose kryen akte të ngjashme seksuale ndaj tyre nga fëmija, të cilat përfshijnë depërtimin në trup, vepra është kryer bashkërisht nga më shumë se një person ose shkelësi, duke kryer veprën, e vë fëmijën në rrezik të dëmtimit serioz të shëndetit ose dëmtimit të konsiderueshëm të zhvillimit të tij fizik ose emocional, Kushdo që në rastet nga neni 176 (1) deri në (3), dhunon rëndë fizikisht fëmijën ose e vë në rrezik vdekjen, dënohet me burgim për së paku pesë vjet”.

3. Trafikimi me fëmijë në Shtetet e Bashkuara të Amerikës

Cdo ditë e cdo vit Shtetet e Bashkuara të Amerikës kanë shkuar duke u bërë vend transit për trafikim të fëmijëve. Ku numër I madh I fëmijëve trafikohen cdo vit në SHBA, me një valë të madhe. Por kjo nuk do të thotë që SHBA nuk ka dhënë kontribut të madh mbi luftimin e këtij krimi. SHBA gjithmonë ka dhënë iniciativë dhe angazhim drejt mbrojtjes së viktimave të trafikuar dhe ndjekjes së tutorëve të trafikimit. Detyrë të vecantë ka përfshirë edhe Qeveria Amerikane duke shtuar kontrollet Brenda shtetit dhe jasht kufijve, për rrualtje sa më të fortë të gjendjes kriminale të trafikimit. Si cdo vend tjetër edhe Amerika , trafikim me fëmijë e kryen në të gjitha format e mundë shme, ku vështirësi më të parapara ka hasur në ndërprerjen për të trafikuar fëmijë për punë të detyruar dhe në shfrytëzime seksi.

Edhe nga ditët e kaluara e deri më sot politika e qeverisë Së SHBA jep efektin për r realizimin e qëllimit, përpjekjet me qëndrueshmëri drejtë masave edukuese dhe eliminimeve të trafikimit.

Mbas shfrytëzimit dhe përdorimit fëmijët duhet të marrin një mbështetje dhe ndihmë të sigurt që nuk është frikësues apo ritraumatizues. Hapësirat miqësore për fëmijët janë një komponent thelbësor për kujdesi të përqendruar te viktimat dhe të informuar nga trauma për fëmijët e mbijetuar të trafikimit të qenieve njerëzore.

Edhe SHBA-në pandemia e COVID-19 rrit cenueshmërinë e fëmijëve ndaj trafikimit për disa arsye. Familjet mund t'u kërkojnë fëmijëve të gjejnë punë për shkak të humbjes së të ardhurave, shërbimet e mbrojtjes së qeverisë dhe OJQ-ve mund të reduktohen dhe fëmijët mund të mos ndjekin shkollën ku kanë akses të rriturit e besuar. Për shkak të kësaj cenueshmërie të shtuar, krijimi dhe mirëmbajtja e hapësirave miqësore për fëmijët është thelbësore për t'u dhënë përparësi gjatë pandemisë; ato madje mund të jenë një vend i sigurt ku fëmijët mësojnë për mbrojtjen e shëndetit publik si distancimi social, mbajtja e maskave dhe higjiena e duhur.²²

4. Trafikimi me fëmijë në Kosovë

Duke u nisur nga përmendja e luftës, nga e gjitha ajo tragjedi dhe masakrat e përjetuara, Kosova si shtet u bë një vend, apo një destinacion kyq nga njerëz dhe komunitete të ndryshme. Përzirja e vendit me të ardhur nga jashtë u rrit edhe më shumë mundësia për trafikim të fëmijëve. Kjo rritje e tmerrshme në Kosovë me hovin e saj pas vitit 1999, me mbarimin e luftës, detyroi që fëmijët, të shfrytëzohen në punë, e detyrime të tjera pa dallim të gjinisë. Cdo fëmijë është i pambrojtur, atëherë kur fëmija shfrytëzohet në forma të ndryshme, ku shumë fëmijë meshkuj sheh në punë të detyruara, shitje të gjërave të ndaluara për fëmijë, në punë jo të natyrshme për fëmijë, ku edhe vajzat detyrohen dhe shfrytëzohen në mardhënie seksuale, pra për prostitucion. Në Kosovë frontin e rrezikshmërisë kanë marrë fëmijët lypsarë, përfshirë këtu edhe Shqipërinë nga krijimi i një rrethi të qarkullimit të këtij biznesi. Këta fëmijë lypsarë i kemi dhe gjinden kudo, në cdo hapësirë, në vende më të dendura sic i kemi në sheshet e qyteteve, dhe jashtëzakonisht

²² [Child-Friendly Spaces for Survivors of Human Trafficking](#)
JULY 1, 2021

nëpër kafene, I parë si një problem aq efikas nga të gjithë ne. Fëmijët lypsarë mund të themi se janë object më I dashur dhe më fitimprurës për trafikantët.

Mund të themi se Kosova, edhe pse në bazë të standarteve është e ulët apo e dobët, përsëri ketu nuk mungojnë organizata, studime, seminare, shoqata të ndryshme në drejtim të hulumtimit të zbardhjes së rasteve të trafikimit me fëmijë, dhe zbulimin e identifikimit të fëmijëve dhe mbrojtjen e tyre, por gjithqka nga kjo mund të jetë e kotë, përderisa mungon iniciativa dhe mbështetja e fortë nga shteti. Qeveria e Kosovës nga niveli I fuqisë qe ka për mbrojtjen e shtetit dhe të shtetasve të vendit, apo të huajve, nuk përmbush kapacitetin për parandalim apo eliminim të trafikimit, edhe pse jep dhe duhet të jep kontribut të madhë drejtuar në këtë qëllim. Qeveria vetëm se paraqet propozime të ndryshme dhe të duhura, për ndjekjen dhe hetimin për mbrojtje të fëmijëve. Iniciativë të vecantë është dhënë edhe nga Policia e Kosovës në bazë të hulumtimit dhe studimeve rreth kaosit shoqëror, I cili jep të dhëna se trafikimi me fëmijë është në një vrull të madhë duke e pasur parasysh edhe gjendjen ekonomike, financiare apo social të shtetit.

Nga të gjithë hulumtimet e kësaj situatë vlen të citohet edhe informimi apo prezentimi i shefit të sektorit qëndror për hetimin e trafikimit me njerëz ku u shpreh se ” 59% e këtyre rasteve të trafikimit janë nën moshën 18 vjeçare, qe kuptohet se kemi të bëjmë me trafikim të fëmijëve”- Riza Murati, 2021- Shef Sektori qëndror.

Sic, e cekëm edhe më lartë për përjetimet e Kosovës, dhe vuajtjet e shtetasve, dhe pasojat që kanë ngelur tek ata, duke sjellur kushtet e rënda ekonomike,një nga arsyet se pse mënyra e jetesës është cdo ditë e më shumë më devijante.

Për qëllime të këtij trafikimi dhe nenit 166 të këtij kodi të Kosovës:

6.1. shprehja “trafikim me njerëz” nënkupton rekrutim, transportim, transferim, strehim ose pranim i personave me anë të kanosjes ose të përdorimit të forcës apo me forma të tjera të shtrëngimit, rrëmbimit, mashtrimit, lajthimit, keqpërdorimit të pushtetit apo të keqpërdorimit të një pozite të ndjeshme ose me anë të dhënies ose marrjes së pagesave apo përfitimeve për të arritur pëlqimin e personit që ka kontroll mbi personin tjetër, me qëllim të shfrytëzimit.

6.2. shprehja "shfrytëzim" ashtu siç është përdorur në nën-paragrafin 6.1. të këtij paragrafi, përfshin, por nuk kufizohet në, shfrytëzimin e prostitucionit të tjerëve, pornografisë ose formave tjera të shfrytëzimit seksual, lëmoshës, shërbimeve ose punës së detyruar, skllavërisë ose veprimeve të ngjashme me skllavërinë, robërisë ose heqjes së organeve apo qelizave.

6.3. pëlqimi i viktimës së trafikimit me njerëz për qëllime shfrytëzimi nuk merret parasysh kur cilado prej mjeteve të përcaktuara më lart në nën-paragrafin 6.1 të këtij neni është përdorur kundër viktimës së tillë.

6.4. rekrutimi, transportimi, transferimi, strehimi ose pranimi i fëmijës me qëllim të shfrytëzimit konsiderohet "trafikim me njerëz", madje edhe nëse kjo nuk përfshin asnjërin nga mjetet e përcaktuara më lartë në nën-paragrafin 6.1 të këtij neni.²³

Kosova si shtet për zhvillimet ndërkombëtare në Ballkan ka dhënë kontributin e vet ndaj viktimave duke përcaktuar edhe Ligji I vitit 2013 që përcepton: Parandalimin dhe luftimin e trafikimit me njerëz në të gjitha format e tij.

"LIGJ PËR PARANDALIMIN DHE LUFTIMIN E TRAFIKIMIT ME NJERËZ DHE MBROJTJEN E VIKTIMAVE TË TRAFIKIMIT"

Mbrojtjen e viktimave të trafikuar, përfshirë sigurimin e të drejtave, si ndihmë juridike, ndihmë mjeksore, mbështetje psikosociale, sigurim i kompensimit dhe të drejtave të tjera, për të gjithë personat që supozohen të jenë ose që identifikohen si të trafikuar, pavarësisht gjinisë, moshës, gjendjes martesore, gjuhës, pa aftësisë fizike apo mendore, orientimit seksual, kombit, mendimit apo bindjes politike, religjionit apo besimit, përkatësisë etnike apo sociale, racës, pronës, lindjes ose statuseve tjera, në përputhje të plotë me instrumentet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut dhe standarteve.^{24 25}

²³ Gazeta zyrtare e republikës së kosovës / nr. 2 / 14 janar 2019, prishtinë 67 kodi nr. 06/l-074 penal i republikës së kosovës

²⁴ [ligji nr. 04/l-218 për parandalimin dhe luftimin e trafikimit me njerëz dhe mbrojtjen e viktimave të trafikimit](#)

5. Trafikimi me fëmijë në Shqipëri

Shqipëria gjithmonë ka qenë vend me fluks të madhë të krimit të organizuar, dhe rrugëve ilegale kriminale. Barazuar në Ballkanin, Shqipëria gjithmonë ka qenë vend destinacioni për tregti ilegale, sidomos të trafikimit me fëmijë. Ky biznes i trafikimit të fëmijëve në Shqipëri tregoi dukshëm rritjen e interesit të trafikantëve nga fitimet e larta. Dhe këtu fillon aktiviteti më i madhë i këtyre lëvizjeve të pakontrolluara, i trafikimit me fëmijë. Shqipëria është e njohur ndërkombëtarisht si një ndër vendet me organizatë kriminale më të përhapur.

Shqipëria rritjen e këtij fenomeni me shumë gjasa të fituar e ka nga grupet mafioze kriminale, gjithë kemi njohuri për MAFIAT SHQIPËTARE, ku lokacioni dhe baza e tyre kryesore vetëm se gjendet në Shqipëri, ku nga këtu vetëm se lindin ato elementet kryesore për kryerjen e kësaj forme të trafikimit.

Nga shumë analiza dhe statistika Shqipëria është vendi që kryeson me nivel më shqetësues. Nga ajo periudhë përderisa kanë ekzistuar mafiat Shqipëtare, asaj kohe kanë filluar të paraqiten edhe bandat me rolin e tyre, ku si rast për tu vecuar është:

- Banda e trafikut të fëmijëve

“Ramiz dhe Xhulieta Petalli, si dhe Nexhip Kaçurri janë tre të arrestuarit, anëtarë të bandës së trafikut të fëmijëve drejt Italisë. Aktiviteti kriminal i tyre ka nisur në vitin 1998 deri në vitin 2002, kur janë zbuluar dhe kanë startuar hetimet. Fëmijë të moshave 6 deri në 12 vjeç merreshin në rrethe të ndryshme të Shqipërisë”.²⁶²⁷

Me këto gjeste Shqipëria përhapet si vend i cili po shkel më së rëndi të drejtat e fëmijëve, edhe sot e kësaj dite ky biznes është në qendër të vëmendjes. Shqipëria në lidhje me trafikimin e fëmijëve ka karakteristika interesante, duke i pasur parasysh arsyet dhe kushtet se si trafikohen

²⁶ https://sq.wikipedia.org/wiki/Bandat_kriminale_shqiptare?veaction=edit§ion=7

fëmijët. Në Shqipëri jo vetëm që fëmijët trafikohen nga trafikantët por ata jipen me vet dëshirë të prindërve, që fëmijët e tyre ti trafikojnë diku, për fitime materiale. Format e trafikimit të fëmijëve kryhen për qëllime të ndryshme, rekrutohen fëmijët në prostitucion, në punë të detyruar, dhe në kryerjen operacioneve të ndryshme kriminale.

Ne fenomenin e trafikut të fëmijëve kanë ndikuar dhe tre krizat politike që ka kaluar Shqipëria gjatë viteve 1990 – 2000. “Kriza e vitit 1997 solli degradimin e qeverisjes dhe thuajse futjen e Shqipërisë në një konflikt civil”, “Kriza e vitit 1998 solli largimin pa dëshirë nga Qeveria të ish-kryeministrit Fatos Nano dhe djegjen e një ndërtese qeveritare”, ndërsa “Lufta e Kosoves e vitit 1999 solli mëse 600 mijë refugjatë kosovarë në tokën e një Shqipërie të varfër dhe të këputur nga një tranzicion i gjatë politik, ekonomik dhe social”, dhe e gjitha kjo bëri bujë të madhe dhe shkatëruese në territorin e gjithë shtetit, dhe shkak që Shqipëria të ketë vështirësi në marrjen e këmbëve të saj, për ngritjen e shtetit në një standart më të lartë , më efikas, shtet më demokartik.²⁸

Nga gjithë analizat, studimet dhe statistikat në Shqipëri është bërë nje statistikë vjetore për të Drejtat e Fëmijëve nga viti 2016, me të gjitha grupmoshat, vendbanimet, gjinisë, etnisë, kombësisë, me tabelën në vijim:

²⁸ Children’s Human Rights Centre of Albania – CRCA

Vendlindja	1. Numri i fëmijëve të trafikuar sipas grupmoshës, gjinisë, vendbanimit, arsimit, etnise, kombesise																
	Total (të gjitha grupmoshat)			0-14 vjeç			14-18 vjeç			Vendbanimi	Arsimi				Etnia		Kombesia
	Gjithsej (F+M)	F	M	Gjithsej (F+M)	F	M	Gjithsej (F+M)	F	M		Cikli 9 vjeçar	I mesem	I lartë	Asnjë klasë	rome	egjiptian	
Berat	5	4	1	2	1	1	3	3	0	Berat							Shqiptare
Dibër	1	1	0	0	0	0	1	1	0		1						Shqiptare
Durrës	1	1	0	0	0	0	1	1	0		1					1	Shqiptare
Elbasan	11	11	0	6	6	0	5	5	0						1	6	Shqiptare
Fier	3	3	0	2	2	0	1	1	0						2		Shqiptare
Gjirokastrë	0	0	0	0	0	0	0	0	0								Shqiptare
Korçë	3	2	1	0	0	0	3	2	1								Shqiptare
Kukës	1	1	0	0	0	0	1	1	0	Tropojë							Shqiptare
Lezhë	1	1	0	0	0	0	1	1	0	Mirditë	1						Shqiptare
Shkodër	3	3	0	0	0	0	3	3	0	Shkoder							Shqiptare
Tiranë	7	6	1	1	1	0	6	5	1						1		Shqiptare
Pogradec	0	0	0	0	0	0	0	0	0								Shqiptare
Vlorë	5	5	0	1	1	0	4	4	0						2		Shqiptare
Nuk ka info	1	1	0	0	0	0	1	1	0								Shqiptare
Total	42	39	3	12	11	1	30	28	2						6	7	

29

Në Shqipëri mbrojtja e fëmijëve është theksuar edhe në kodin penal të Shqipërisë ku perception pjesët me direkte që nevojiten në ndihmë dhe në mbështetje të viktimave fëmije ndaj cënimit të të drejtave të jetesës bazuar në nenet në vijim:

Neni 286 :

“Nxitja për përdorimin e drogës Nxitja e të tjerëve për përdorimin e drogës narkotike ose të substancave psikotrope apo injektimi i tyre pa pëlqimin e të dëmtuarit, dënohet me burgim nga pesë gjer në dhjetë vjet. Kur nxitja apo injektimi i detyruar bëhet ndaj fëmijëve apo në institucione penale, shkollore, sportive apo të çdo veprimtarie tjetër shoqërore dënohet me burgim nga dhjetë gjer në pesëmbëdhjetë vjet”.

²⁹ file:///C:/Users/DIZ-Skopje8/Desktop/Vjetar-Statistikor-p%C3%ABr-%C3%87%C3%ABshtjet-e-t%C3%AB-Drejtave-t%C3%AB-F%C3%ABmij%C3%ABve-20161.pdf

Neni 128/b

“Trafikimi i fëmijëve Trafikimi i fëmijëve me qëllim fitimi material ose çdo përfitim tjetër dënohet me burgim nga dhjetë gjer në njëzet vjet. Po kjo vepër, kur kryhet në bashkëpunim ose më shumë se një herë, ose shoqërohet me keqtrajtimin dhe detyrimin me dhunë fizike ose psikike të të dëmtuarit për të kryer veprime të ndryshme, ose sjell pasoja të rënda për shëndetin, dënohet me burgim jo më pak se pesëmbëdhjetë vjet dhe kur ka sjellë si pasojë vdekjen, me burgim të përjetshëm”.³⁰Neni 110/c

Veprimet që lehtësojnë trafikimin

Po kjo vepër, kur kryhet në bashkëpunim, më shumë se një herë, apo është kryer nga personi që ka për detyrë të lëshojë letërnjoftimin, pasaportën, vizën apo dokumentin e udhëtimit, ose ka mundësuar trafikimin e fëmijëve, dënohet me burgim nga katër deri në tetë vjet. Po kjo vepër, kur ka sjellë pasoja të rënda, dënohet me burgim jo më pak se pesë vjet.”.

Marrë nga perceptimet e lartpërmendura kuptojmë që Shqipëria si vend ka nevojë për më shumë kontribut dhe iniciativë për luftimin, parandalimin dhe mbrojtjen e fëmijëve, nevojitet një strategji më e specializuar, për sigurim më efikas, analizë më të detajuar të situatave , që të arrihet kontroll i duhur mbi trafikantët, specializim më rigoroz ndaj strukturës së mbrojtjes së fëmijëve. Krijimi i strategjisë, krijimi i grupeve për qëllim mbijetese, për tejkalim të çdo lloji situatave, për mbrojtje nga rreziqtë që mund të paraqiten nga brenda ashtu edhe nga jashtë vendit.

Sistemi politik, shtetëror, dhe legjislativi duhet që të mbështeten në të njëjtën ide profesionale për arritjen e qëllimit specifik, bazuar edhe në të gjitha aktet ligjore të mëposhtme:

Aktet Ligjore

“-Ligji nr. 7895, datë 27.01.1995 “Për Kodin Penal të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar;

³⁰ KODI PENAL I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË Miratuar me ligjin nr.7895, datë 27.1.1995

-Ligji nr. 8920, datë 11.7.2002, “Për ratifikimin e Konventës së Kombeve të Bashkuara kundër Krimit të Organizuar Ndërkombëtar dhe dy protokolleve shtesë të saj”;

- Ligji nr. 9188, datë 12.02.2004, shtesa për Kodin Penal ka prezantuar veprën penale të trafikimit të femrave dhe trafikimit të të miturve. Ligji prezanton përkufizime të reja për veprën e trafikimit në përputhje me Protokollin e Palermos për Trafikimin;

-Ligji nr. 9187, datë 12.02.2004 “Për disa ndryshime në Kodin e Procedurës Penale në lidhje me përdorimin e mjeteve të posaçme të hetimit si: përgjimet, agjentët e infiltruar, etj., përdorur për hetimin e krimit të organizuar përfshirë edhe trafikimin e personave;

-Ligji nr. 9544, datë 29.05.2006 “Për ratifikimin e Marrëveshjes midis Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës Greke, për Mbrojtjen dhe Asistencën për Fëmijët Viktima të Trafikimit”;

-Ligji nr. 9642, datë 20.11.2006 “Për ratifikimin e Konventës së Këshillit të Evropës “Për Veprim kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore”;

-Ligji nr. 9833, datë 22.11.2007 “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Protokollin Opsional të Konventës së OKB-së për të Drejtat e Fëmijëve për përfshirjen e fëmijëve në konflikte të armatosura”;

-Ligji nr. 9834, datë 22.11.2007 “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Protokollin Opsional të Konventës së OKB-së për të Drejtat e Fëmijëve, për shitjen e fëmijëve, prostitucionin e fëmijëve dhe pornografinë e fëmijëve”;

- Ligji nr. 9859, datë 21.01.2008 Për disa shtesa dhe ndryshime në Kodin Penal ku nenet e shtuara janë neni 124/b,

”Këqtrajtimi i fëmijëve”, i cili midis të tjerave kriminalizon fenomenin e shfrytëzimit të fëmijëve për punë të detyruar, lypje dhe shërbime të tjera të detyruara;

paragrafi që u shtua në nenin 117 “Pornografia” në lidhje me pornografinë e të miturve, si dhe amendimi i nenit 128/b

³¹ “Trafikimi i të miturve”, i cili kriminalizon me ligj jo vetëm rekrutimin, fshehjen, marrjen e fëmijëve, por edhe shitjen e tyre;”³²

6. Trafikimi me fëmijë në Republikën e Maqedonisë së Veriut

Edhe Shteti i Maqedonisë së Veriut has me numër të madhë të trafikimit me fëmijë, dhe përballet me problemin e asaj që cdo fëmijë mund të bie si viktimë e trafikimit. Trafikimi i fëmijëve në Maqedoni kryhet në forma të ndryshme. Në Maqedoni trafikimi me fëmijë është dukuri e krimit të organizuar, dhe shqetësim si për qytetarët ashtu edhe për institucionet dhe organet përkatëse. Nga numri i madhë i rasteve me trafikim të fëmijëve, kemi ndeshje edhe me problematikën për ti përcaktuar karakteristikat e këtij krimi dhe numër të caktuar se sa është rrjedhoja e trafikimit brenda vendit. Fuqia e Maqedonisë për ta përballuar këtë formë krimi nuk është edhe aq stabile, dhe nuk ka standarte për ta kontrolluar dhe menaxhuar situatën e parandalimit dhe eliminimit të trafikimit me fëmijë.

E ditur që nuk mund të kontrollohet kjo situatë të themi tragjike, duke i pasur parasysh rrethanat dhe gjendjen ekonomike të vendit tonë, mungesë të papunsisë, mungesa e edukimit dhe arsimit, si dhe përkrahja nga prindërit, ku kjo është pjesa me rolin më kyqes. Ndjesia dhe rrezikshmëria e trafikimit të fëmijëve në Maqedoni, është e rritshme, ngase Maqedonia është i

³²Strategjia Kombetare në Luftë Kunder Trafikut të Qenieve Njerezore

<https://www.crca.al/sites/default/files/publications/Trafiku%20i%20Femijeve%20ne%20Shqiperi%2C%20CRCA%202003.pdf>

KODI PENAL I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË Miratuar me ligjin nr.7895, datë 27.1.1995

STRATEGJIA E LUFTËS KUNDËR TRAFIKIMIT TË PERSONAVE DHE PLANI I VEPRIMIT 2014 – 2017

Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 499, datë 29.8.2018 Për miratimin e procedurave standarde të veprimit për mbrojtjen e viktimave dhe viktimave të mundshme të trafikimit..... 8641

<http://femijet.gov.al/al/wp-content/uploads/2017/12/Vjetar-Statistikor-p%C3%ABr-%C3%87%C3%ABshtjet-e-t%C3%AB-Drejtave-t%C3%AB-F%C3%ABmij%C3%ABve-20161.pdf>

<https://www.tatime.gov.al/c/424/431/njihuni-me-ligjin-dhe-draft-aktet-nenligjore>

paraparë me një dukuri si vend dhe destinacion transiti për fëmijët meshkuj e femra. Në Maqedoni trafikimi me fëmijë kryhet në format më të tmershme duke i përdorur dhe duke i shfrytëzuar për punë të dhunshme, dhe torturuese për moshën e fëmijëve, dhe nënshtrimin me dhunë për shfrytëzime seksuale.

Maqedonia, qeveria e Maqedonisë është e vetëdijshme për situatën momentale që gjendet vendi, dhe monitoron një fushë për zhvillim dhe pregaditje të një procesi për një investim adekuat ndaj fëmijëve, për të ndihmuar në mbijetesën e tyre, zhvillimin e tyre, për gjendjen shëndetësore të fëmijëve, gjendjen emocionale, psikologjike, dhe nivelin e pasojës në të cilën gjenden fëmijët nga shfrytëzimi, abuzimet seksuale, dhe dhunës ndaj detyrimit për fuqi punëtore.

Të drejtat e fëmijëve mbështeten dhe trajtohen në formë mjaftë të drejtë dhe specifike duke u bazuar në një numër të madhë të instrumenteve dhe ligjeve, që parashihen të nevojshme në cdo vend dhe cdo legjislacion.

Bazuar në aspekt juridik, dhe në bazë të Kodit Penal të RM –Neni 418-a :

“Ai i cili me forcë, kërcnim serioz qon në lajthim apo forma tjera të shtrëngimit, grabitjes, mashtrimit, marrjen e kontrollit ndaj personit tjetër për ti eksploatuar përmes prostitucionit ose formave tjera të pornografisë, punës së dhunshme apo të shërbyerit, roberimit, do të dënohet me së paku katër vjet burgim. Ai i cili do të merr apo shkatërron letërnjoftimin, pasaportën apo ndonjë document tjetër të huaj për identifikimin për të kryer vepër penale nga paragrafi 1, dënohet me katër vjet burgim, Ai i cili shfrytëzon apo i mundëson tjetrit zhfrytëzimin e shërbimeve seksuale apo ndonjë forme tjetër të eksploatimit të personave për të cilët ka ditur apo ka qenë i detyruar të dijë se janë viktimat të tregtisë me njerëz, do të dënohet me burgim prej gjashtë muaj deri në pesë vjet.”³³

Republika e Maqedonisë së Veriut ka edhe ratifikimin e dokumenteve ndërkombëtare,” në tetor të 2004 pranoi apo ratifikoi Konvenën e OKB-së kundër kriminalitetit transnacional dhe

³³ Kodi Penal I RMV

dy protokolet që i kushtohen dënimit të tregtisë me njerëz, vecanërisht me fëmijë , e cila në përputhje me Kushtetutën e Republikës së Maqedonisë edhe ky document ndërkombëtar është pjesë përbërëse e rendit juridik në planin e luftës kundër tregtisë me njerëz.³⁴

Instrumentet e brendshme juridike:

- **Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë së Veriut**

1. Liritë dhe të drejtat civile dhe politike

- *Neni 9 :*

“Qytetarët e Republikës së Maqedonisë janë të barabartë në liritë dhe të drejtat pavarësisht nga gjinia, raca, ngjyra e lëkurës, prejardhja kombëtare dhe sociale, bindja politike dhe fetare, pozita pronësore dhe shoqërore.

Qytetarët janë të barabartë para Kushtetutës dhe ligjeve”.

- *Neni 10:*

“Jeta e njeriut është e pacenueshme.

Në Republikën e Maqedonisë nuk mund të shqiptohet dënimi me vdekje sipas asnjë baze”.

- *Neni 11:*

“Integriteti fizik dhe moral i njeriut janë të pacenueshëm.

Ndalohet çdo formë e torturës, e sjelljes dhe e dënimit çnjerëzor dhe poshtërues.

Ndalohet puna me detyrim”³⁵

³⁴ Kodi Penal I RMV

Kriminaliteti i organizuar- aspekte juridike - Jovan Ilievski, Nenad Janicevi

³⁵  Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë së Veriut, Numër 08-4642/1 17 nëntor 1991, Shkup

- **LIGJ PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJIT PËR REGJISTRIN E VEÇANTË PËR PERSONA TË DËNUAR ME AKTVENDIM TË PLOTFUQISHËM PËR VEPRA PENALE PËR KEQPËRDORIM SEKSUAL TË PERSONAVE TË MITUR DHE PEDOFILI**

“Neni 1 : Në Ligjin për Regjistrin e veçantë për persona të dënuar me aktvendim të plotfuqishëm për vepra penale për keqpërdorim seksual të personave të mitur dhe pedofili ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 11/12), neni 3 ndryshohet si vijon:

"Regjistri përmban të dhëna për persona të dënuar me aktvendim të plotfuqishëm për vepra penale kundër lirisë gjinore dhe moralit gjinor të kryer kundër fëmijëve³⁶:

- 1) *përdhunim (neni 186 paragrafi 2 i Kodit penal);*
- 2) *akt seksual të dhunshëm ndaj personit të pafuqishëm (neni 187 paragrafi 2 i Kodit penal);*
- 3) *sulm seksual mbi fëmijë i cili nuk i ka mbushur 14 vjet (neni 188 i Kodit penal);*
- 4) *akt seksual të dhunshëm me keqpërdorim të pozitës (neni 189 paragrafi 2 i Kodit penal);*
- 5) *kënaqje të epsheve seksuale para tjetrit (neni 190 paragrafët 2 dhe 3 i Kodit penal);*
- 6) *prostitucion të fëmijëve (neni 191-a i Kodit penal);*
- 7) *shfaqje e materialeve pornografike fëmijës (neni 193 i Kodit penal);*
- 8) *prodhim dhe shpërndarje të pornografisë së fëmijëve (193-a i Kodit penal);*
- 9) *mashttrim për akt seksual të dhunshëm ose veprim tjetër seksual ndaj fëmijëve të cilët nuk i kanë mbushur 14 vjet (neni 193-b i Kodit penal);*
- 10) *incest (neni 194 paragrafi 2 i Kodit penal) dhe*

³⁶ Arifi B., Ratkoceri V., Selmani-Bakiu A., Metaj – Stojanova A., Ibish E., - Të drejtat e fëmijëve: sfidat dhe perspektivat e reja – Tetovë, 2022

11) tregti me fëmijë (418-g nga Kodi penal)." ³⁷

KUJDESTARIA MBI PERSONAT E MITUR VIKTIMA TË TRAFIKUT ME NJERËZ

Neni 177-a:

"Fëmijë-viktimë e trafikut me njerëz është personi i mitur deri në moshën 18 vjeçare, i cili me ose pa pëlqimin e tij ,në çfarëdo mënyre, është bërë viktimë e trafikut me njerëz me qëllim të eksploatimit. Në rast të pasigurisë për moshën e viktimës dhe kur ekzistojnë shkaqe të besohet se ai është fëmijë, mendohet se është fëmijë dhe derisa pritet të konfirmohet mosha e tij, i shqiptohen masa për mbrojtje të cilat janë të parapara për fëmijën-viktimë të trafikut me njerëz."

Neni 177-b:

"Qendra për punë sociale çdo herë kur do të marrë njoftim nga Ministria e Punëve të Brendshme, se është identifikuar person i mitur-viktimë e tregtisë me njerëz, menjëherë merr masa për mbrojtjen e personit, të drejtave dhe interesave të fëmijës dhe e vendos nën kujdestari. Për kujdestar të personit të mitur – viktimë e tregtisë me njerëz caktohet personi i cili është i përgatitur për punë me fëmijët-viktima të trafikut me njerëz".

Që të mund të mbrohen viktimat në Maqedoni neve duhet që të japim kontributin tonë për identifikimin e tyre, arritja e këtij qëllimi mund të vijë vetëm nëpërmjet fuqisë së organeve kompetente , që përmbajnë një staf mjaftë të trajtuar në këtë lëmi. Organet apo institucionet përkatëse mund të bëjnë identifikimin duke vënë në pah gjithë gjendjen emocionale dhe psiqike të fëmijëve. Gjithë kjo procedurë kryhet duke u bazuar në të dhënat që i grumbullojmë, detajet, informacionet, për të fituar një përfundim më të saktë, për ta kuptuar gjendjen e statusit që e ka fituar viktimat, dhe me këtë situatë realizohet operacioni më i suksesshëm në mbrojtje të fëmijëve dhe viktimave.

³⁷ Ligj për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Regjistrin e Veçantë për persona të dënuar me aktvendim të plotfuqishëm për vepra penale për keqpërdorim seksual të personave të mitur dhe pedofili (112/14

Përfundime dhe rekomandime

Me këtë hulumtim janë përmendur dhe prekur qëllimet kryesore për fenomenin transnacional, për të ndermarre masa, për orientim me të mirë në luftën e trafikimit të fëmijëve, për ta kuptuar vendin dhe karakteristikat e trafikimit të fëmijëve. Me këtë krim e kuptojmë ndjesinë dhe rëndësinë e shkeljes së lirisë apo drejtës së një personi të pafajshëm. Ky krim apo kjo vepër penale tregon një numër të madh të papërshtatshëm marramendës të njerëzve të cilët janë viktimë të qenieve njerëzore. Nga e gjithë kjo sfidë e trafikimit me njerëz, që me përdorim të forcës paraqitet një akt abuzimi, konkludojmë në atë që qëllimi i trafikantëve është që personat të shfrytëzohen, të nënshtrohen, të viktimizohen dhe të përdoren në robëri apo në skllavëri, dhe në mënyra të ndryshme trafikuese i cili mund të përqëndrohet në çfarëdo lloje forme.

Ku çdo formë e kryerjes së këtij lloji të trafikimit është paraqitur në pika të ndara dhe të sqaruara në mënyrë mjaftë të qartë, dhe të drejtë, se sa duhet mudi dhe kontributi i jetë i madh në iniciativat drejt luftimit të këtij krimit kriminal.

Në këtë hulumtim analizë e vecantë i është bërë shkaqëve të trafikimit, llojeve të trafikimit, arsyet se pse vjen deri tek trafikimi, sa është pasha e rëndë e shfrytëzimit të fëmijëve në formë të ndryshme të trafikimit. Nga e cila vijmë në përfundim se numër i madh vërehet dukshëm në rritje të ytrafikimit të fëmijëve, dhe vetedije e qytetarëve, në parandalimin, dhe luftimin e këtij krimit.

Arsyet pse dikush kryen një krim mund të jenë po aq të ndryshme siç janë të ndryshëm vet njerëzit që kryejnë krimet. Disa nga shkaqet e ndryshme që ndikojnë në kryerjen e trafikimit me fëmijë mund të jenë financiare, emocionale, intelektuale, sjellja devijuese etj.

Gjatë këtij hulumtimi është realizuar analizë e detajuar e legjislacioneve të disa shteteve që ka të bëjë me krimin trafikimit të fëmijëve. Ajo që dukshëm vërehet është se në shtetet siç janë Gjermania, Afrika, SHBA, Kosova, Shqipëria dhe Maqedonia, funksionojnë institucione të posaçme për luftimin e krimit.

Analiza komparative dëshmon se të gjitha shtetet kanë të parapara sanksionime të rënda për të gjitha llojet e krimit të trafikimit pa dallim

Duke pasur parasysh se ky krim ka arritur të përhapet në masë të gjërë, përmes një analize komparative, në mënyrë të veçantë u kuptuan analizat e krimit të trafikimit me fëmijë dhe lufta kundër tij në disa vende, me qëllim që të arrijmë në përfundim drejtë luftimit të këtij fenomeni.

Rezultatet nga hulumtimi i kryer rreth krimit , bëjnë që të sjellet përfundimi se janë të nevojshme masa dhe aktivitete shtesë për përmirësimin e gjendjes aktuale, me të cilat sistemi do të funksionojë në mënyrë shumë më efikase dhe transparente. Masat dhe aktivitetet e propozuara i prezentojmë në disa drejtime, edhe atë:

- Duke mos lene anash edhe, per te ndermarre masa , per orientim me te mire ne luftën e trafikimit te fëmijëve,per ta kuptuar vendin dhe karakteristikat e trafikimit te fëmijëve.
- Përfshirje më të shumtë të institucioneve përkatëse në kontributin e tyre drejtë luftimit të trafikimit me fëmijë.
- Të ketë harmonizim të ligjeve për mbrojtje të fëmijëve nga cdo lloj shfrytëzimi, dhe torture.
- Të ketë bashkëpunime dhe mbështetje më efektive të legjislacioneve të ndryshme dhe bashkëpunime ndërkombëtare.
- Iniciativë më aktive dhe drejtëvepruese të organeve, organizatave, dhe institucioneve drejtë masave për luftim të trafikimit me fëmijë.
- Nevojë më e madhe për ligjërime në cdo ambient pune, shkolle, apo kudo, se si ti largohemi kësaj varësie negative, në mbrojtjen e fëmijëve.
- Të ketë kufizime dhe kontrole në nivele të shumta në pikat kufitare.
- Rrespektim të rritur të ligjit, dhe respektim të rregullave, të vlefshme për cdo qytetar.

Bibliografia

- Naim Tota , Trafikimi me qënje njerëzore,aspekte penale juridike, krahasuese dhe kriminologjike, parathënie nga Prof.dr. Skënder Kacupi
- Bistra Netkova & Ismail Zejneli , Trafikimi me njerëz aspektet juridike,2006
- Delikuenca e të miturve, Prishtinë 2018
- Organized Crime, Howard Abadinsky, 2012
- Arifi B., Ratkoceri V., Selmani-Bakui A., Metaj – Stojanova A., Ibish E., - Të drejtat e fëmijëve: sfidat dhe perspektivat e reja – Tetovë, 2022 ISBN 978-608-248-049-7
- Kriminaliteti i organizuar, Tetovë, 2009, Vllado Kambovski, Nenad Janicevic, Vesel Latifi, Zoran Sulejmanov, Bistra Netkova, Ismail Zejneli, Jovan Ilievski, Zlat Milanovic
- Казнено – правна регулатива и анализа на случаи на трговија со луѓе , од Македонија, Србија, Албанија, Црна Гора и Босна Херцеговина- Penalty and legal Regulation and Analysis of Cases of trafficking in human Beings from Macedonia, Serbia, Albania, Montenegro and Bosnia and Herzegovina, Ray Power & Jelena Krasic, 2007
- Glenny, M. (2012). Darkmarket: How hackers became the new mafia. Random House ;
- Dr.sc. Vesel Latifi & Dr.sc. Ragip Halili, Tetove 2017
- Prof.dr. Vesel Latifi, Zbulimi dhe të provuarit e krimit , Prishtinë, 2014
- Prof.dr. Vesel Latifi- Prof.as.dr. Agron Beka, Vrasjet, krimi i organizuar, terrorizmi.
- Ismail Zejneli. International Standards Regarding Protection of Children of Maltreatment. In International Standards Regarding Protection of Children of Maltreatment, pp. 7. Prizren Social Science Journal, Prizren, 8 / 2021. ISBN 2616-387X
- Netkova.B & Zejneli.I. Human right and domestic violence with emphasis on Republic of Macedonia
- I.Zejneli. Human rights, protection and help of victims of human trafficking in Republic of Macedonia. In Human rights, protection and help of victims of human trafficking in Republic of Macedonia, pp. 7. Advokatura, nr.22./07, 9 / 2007.

- Ismail Zejneli. The challenges of human trafficking, National and International aspects. In The challenges of human trafficking, National and International aspects, pp. 9. Vionet , Shkup- RMV, 2 / 2021.
- Besa Arifi- The Rights of Victims of crime – A comparative Approach to the Legislation in USA and Macedonia.
- EUROPOL ,” Child Sexual Exploitation Fact Sheet 2011”
- Goppinger, Hans, “Kriminologie”, Munchen, 1997
- Halili,Ragip, “Kriminologjia”, Prishtinë, 2011
- Jovašević D., Leksikon krivicnog prava, JP Sluzbeni list, Beograd
- Kambovski,Vlado, E drejta penale – pjesa e përgjithshme (përkthim), 2004
- Kambovski,Vlado, Komentar na Krivicniot Zakonik na Republika Makedonia,botimi i dytë, Shkup, 2015
- Kambovski,Vlado, & Zejneli.I, E drejta penale-Tetovë, 2018
- Latifi,Vesel, Kriminalistika- Zbulimi dhe të provuarit e krimit, Botimi i gjashtë, Prishtinë, 2009
- Latifi, Vesel, “Kriminalistika”, Prishtinë, 2014
- Mendez, F. “The European Union and cybercrime: insights from comparative federalism”. Journal of European Public Policy,2005.
- Sulejmanov,Zoran, “Македонска Криминологија”, Shkup, 2000
- Wall, David, ”Crime and the Internet”, London, 2001,
- Zejneli,Ismail. Sahiti,Ejup. E drejta e procedurës penale e Republikës së Maqedonisë,Shkup, 2017

Ligje, Konventa dhe dokumente të tjera:

- Kodin Penal i Republikës së Maqedonisë së Veriut ;
- Ligjin për procedurë penale;
 - Ligji për familje
 - Ligji për të drejten e të miturve (Gazeta zyrtare)

- Ligji mbi të drejtat e fëmijëve RM, 2013
- Konventa e të drejtave të fëmijëve (1989)

Burime nga interneti:

- <http://nacionalnakomisija.gov.mk/wp-content/uploads/2016/12/NAP-alb-2006-2009.pdf>
- <https://www.nspcc.org.uk/what-is-child-abuse/types-of-abuse/child-trafficking/>
- <https://www.unicefusa.org/mission/protect/trafficking>
- https://en.wikipedia.org/wiki/Trafficking_of_children
- <https://www.ilo.org/ipec/areas/Traffickingofchildren/lang--en/index.htm>
- <https://theirworld.org/explainers/child-trafficking#section-1>
- [https://www.thelancet.com/pdfs/journals/lancet/PIIS0140-6736\(04\)17624-1.pdf](https://www.thelancet.com/pdfs/journals/lancet/PIIS0140-6736(04)17624-1.pdf)
- [https://www.europarl.europa.eu/RegData/etudes/STUD/2015/536471/IPOL_STU\(2015\)536471_EN.pdf?fbclid=IwAR22SJFVBOxuwYdg3jOIO-DmJ9PRzCYNu_MrxxlZhyZHKgEAPdZGHIE4oZw](https://www.europarl.europa.eu/RegData/etudes/STUD/2015/536471/IPOL_STU(2015)536471_EN.pdf?fbclid=IwAR22SJFVBOxuwYdg3jOIO-DmJ9PRzCYNu_MrxxlZhyZHKgEAPdZGHIE4oZw) ;
- https://www.dw.com/en/slight-rise-in-cybercrime-in-germany-in-2018/a-51203212?fbclid=IwAR1HFe1HIsY-AMdtqBv_ovrC27DyKUEzK_UX5Zsz2SZ4Y_a1RgPO-CrEoEo
- https://www.icmpd.org/file/download/52064/file/Media_and_THB_Guidelines_AL_v.1_.pdf
- https://www.icmpd.org/file/download/52064/file/Media_and_THB_Guidelines_AL_v.1_.pdf
- https://sq.wikipedia.org/wiki/Trafikimi_i_f%C3%ABmij%C3%ABve_n%C3%AB_Kosov%C3%AB
- <https://migrants-refugees.va/documents/al/print/a4/pastoral-orientations-on-human-trafficking.pdf>
- http://jus.igjk.rks-gov.net/747/1/160813_Konventat%20finale_final%20version_shqip.pdf
- <https://www.voipshield.com/the-16-most-common-types-of-cybercrime-acts/> ;
- <https://www.pandasecurity.com/mediacenter/panda-security/types-of-cybercrime/> .

- <https://esem.org.mk/pdf/Publikacii/2017/ESE%20Vodic%20za%20trgo%20so%20lugje%20A6%20062017%20AL%202.pdf>
- <https://kazistop.mk/sq/fillimi/>
- <https://mk.usembassy.gov/sq/raporti-vjetor-per-terrorizmin-ne-shtetet-mbare-botes-ne-2016/>
- <https://www.crca.al/sites/default/files/publications/Strategjia%20kunder%20trafikimit%20te%20femijeve%20e%20miratuar%20me%20vkm.pdf>
- <https://www.unicef.org/albania/sq/deklarata-shtypi/unicef-dhe-partner%C3%ABt-e-koalicionit-kund%C3%ABr-trafikimit-t%C3%AB-bashkuar-p%C3%ABr-t%C3%AB>
- <https://alsat.mk/femijet-dhe-femrat-kategorite-me-te-rrezikuar-nga-trafikimi-me-njerez-ne-maqedoni/>
- <https://www.rolplatform.org/dita-e-pesteboterore-kunder-trafikimit-te-personave-dhe-fokusi-ne-trafikimin-e-femijeve/>
- <https://www.pravdiko.mk/vo-porast-trgovijata-so-detsa/>
- <https://dokumen.tips/documents/leksione-e-te-drejtave-te-njeriut.html>
- <http://nacionalnakomisija.gov.mk/wp-content/uploads/2016/12/NAP-alb-2006-2009.pdf>
- <https://www.unicef.org/montenegro/media/9291/file/MNE-media-MNEpublication505.pdf>
- <https://rm.coe.int/168046e1e3>
- <https://www.nspcc.org.uk/what-is-child-abuse/types-of-abuse/child-trafficking/>
- <https://www.unicefusa.org/mission/protect/trafficking>
- https://en.wikipedia.org/wiki/Trafficking_of_children
- <https://www.ilo.org/ipecc/areas/Traffickingofchildren/lang--en/index.htm>
- <https://theirworld.org/explainers/child-trafficking#section-1>
- [https://www.thelancet.com/pdfs/journals/lancet/PIIS0140-6736\(04\)17624-1.pdf](https://www.thelancet.com/pdfs/journals/lancet/PIIS0140-6736(04)17624-1.pdf)
- https://www.icmpd.org/file/download/52064/file/Media_and_THB_Guidelines_AL_v.1_.pdf

- https://sq.wikipedia.org/wiki/Trafikimi_i_f%C3%ABmij%C3%ABve_n%C3%AB_Kosov%C3%AB
- <https://migrants-refugees.va/documents/al/print/a4/pastoral-orientations-on-human-trafficking.pdf>
- http://jus.igjk.rks-gov.net/747/1/160813_Konventat%20finale_final%20version_shqip.pdf
- <https://esem.org.mk/pdf/Publikacii/2017/ESE%20Vodic%20za%20trgo%20so%20lugie%20A6%20062017%20AL%202.pdf>
- <https://kazistop.mk/sq/fillimi/>
- <https://mk.usembassy.gov/sq/raporti-vjetor-per-terrorizmin-ne-shtetet-mbare-botes-ne-2016/>
- <https://www.crca.al/sites/default/files/publications/Strategjia%20kunder%20trafikimit%20te%20femijeve%20e%20miratuar%20me%20vkm.pdf>
- <https://www.unicef.org/albania/sq/deklarata-shtypi/unicef-dhe-partner%C3%ABt-e-koalicionit-kund%C3%ABr-trafikimit-t%C3%AB-bashkuar-p%C3%ABr-t%C3%AB>
- <https://alsat.mk/femijet-dhe-femrat-kategorite-me-te-rrezikuar-nga-trafikimi-me-njerez-ne-magedoni/>
- <https://www.unodc.org/unodc/en/human-trafficking/global-report-on-trafficking-in-persons.html>
- <https://www.rolplatform.org/dita-e-pestre-boterore-kunder-trafikimit-te-personave-dhe-fokusi-ne-trafikimin-e-femijeve/>
- <https://childhub.org/sq/series-of-child-protection-materials/trafficking>
- <https://jhrmk.org/index.php/trgovija-za-trudova-eksploatatsija/>
- <https://masht.rks-gov.net/uploads/2015/12/manuali-per-mesuesbashkohuni-me-nete-parandalojme-trafikimin-e-qenieve-njerezore.pdf>
- <https://www.crca.al/sites/default/files/publications/Trafiku%20i%20Femijeve%20ne%20Shqiperi%20C%20CRCA%202003.pdf>

- <https://childhub.org/sq/webinar-e-mbi-mbrojtjen-e-femijeve/teknika-te-avancuara-te-keshillimit-psikologjik-me-grupet-e-targetuara-viktima-te-trafikimit-abuzimit-seksual-dhe-dhunes-ne-familje>
- <https://childhub.org/sq/aktivitetet-e-mbrojtjes-se-femijeve-ne-europen-juglindore/konferenca-globale-online-mbi-dhunen>
- <https://childhub.org/sq/online-biblioteka-o-djecijoj-zastiti/parandalimi-i-trafikimit-te-genieve-njerezore>
- <https://childhub.org/sq/burime-multimedia-mbi-mbrojtjen-e-femijeve/trafikimi-i-femijeve-dhe-skllaveria-moderne>
- [https://www.unodc.org/documents/Advocacy-Section/HTMSS Thematic Brief on COVID-19.pdf](https://www.unodc.org/documents/Advocacy-Section/HTMSS%20Thematic%20Brief%20on%20COVID-19.pdf)
- [https://mb.gov.al/wp-content/uploads/2018/02/Strategjia e Luftes kunder Trafikimit te Personave dhe Plani i Veprimit 2014 - 2017.pdf](https://mb.gov.al/wp-content/uploads/2018/02/Strategjia_e_Luftes_kunder_Trafikimit_te_Personave_dhe_Plani_i_Veprimit_2014_-_2017.pdf)
- <https://www.unicef-irc.org/publications/325-child-trafficking-in-west-africa-policy-responses.html>